



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

TEMA:

“PASOJAT E LIDHJES SË MARTESËS SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT”

Mentor:

Doc.Dr. Albana Metaj-Stojanova

Kandidat:

Flora Ismaili

Shkup, 2023

Deklaratë e autorësisë

Unë, Flora Ismaili, e lindur më 06 Janar 1995 në Shkup, studente në Universitetin e Evropës Juglindore me ID 122170, në Fakultetin juridik në programin master E Drejta Civile, vërtetoj se unë jam autor origjinal i punimit “Pasojat e lidhjes së martesës sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Sipas njohurisë time punimi nuk përmban asnjë material të botuar nga dikush tjetër përpos burimeve që janë të cituara në mënyrë të rregullt dhe të cilat janë vënë dukshëm në tekst. Universitetit i barten të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Flora Ismaili

ABSTRAKT

Ky punim shqyrton dhe analizon pasojat, pra efektet juridike të lidhjes së martesës sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut. Do të shqyrtohen si efektet pasurore që lindin për bashkëshortët si pasojë e lidhjes së martesës, ashtu dhe efektet personale të lidhjes së martesës. Në hyrje të punimit jepet një vështrim i shkurtër historik mbi institutin e martesës në përgjithësi dhe procedurën e lidhjes së martesës në veçanti. Më pas në një kapitull të veçantë trajtohen disa nocione të përgjithshme në lidhje me institutin e martesës si: nocioni i martesës, kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës, procedura ligjore, detyrimet e bashkëshortëve, kurorëzimi e shumë aspekte të tjera të institutit të martesës. Teza vazhdon më tej me trajtimin e pasojave që sjell lidhja e martesës, gjë që përbën dhe objektin kryesor të këtij punimi, me ç'rast janë analizuar në mënyrë të detajuar pasojat personale, jo pasurore, si dhe pasojat pasurore të lidhjes së martesës. Për realizimin e qëllimit të punimit jemi mbështetur në përdorimin e këtyre metodave kryesore të hulumtimit: në metodën e analizës, metodën doktrinare (përshkruese) dhe në disa raste edhe në metodën krahasimore dhe atë historike.

Fjalët kyçe: *martesë, pasoja personale të lidhjes së martesës, pasoja pasurore të lidhjes së martesës, procedura e kurorëzimit etj.*

ABSTRACT

This paper examines and analyzes the consequences, i.e., the legal effects of marriage according to the legislation of North Macedonia. Both the property effects arising for the spouses as a result of the marriage and the personal effects of the marriage will be examined. In the introduction of the paper, a brief historical overview is given of the institution of marriage in general and the procedure of marriage. Then, in a separate chapter, some general notions related to the institution of marriage are treated, such as the notion of marriage, the conditions for the binding and validity of marriage, legal procedure, the obligations of spouses, coronation, and many other aspects of the marriage institution. The thesis continues further with the treatment of the consequences of marriage, which constitutes the main object of this paper, in which case the personal, non-property, as well as property consequences of the marriage, are analyzed in detail. For the realization of the purpose of the paper, we relied on the use of the following main research methods : the analysis method, the doctrinal (descriptive) method, and in some cases also the comparative and historical method.

Keywords: *marriage, personal consequences of marriage, property consequences of marriage, coronation procedure, etc.*

АПСТРАКТ

Овој труд ги испитува и анализира последиците, односно правните ефекти од склучувањето на бракот според законодавството на Северна Македонија. Ќе се испитаат и имотните ефекти кои произлегуваат за брачните другари како резултат на склучување на бракот, како и личните ефекти или последици од бракот. Во воведот на трудот е даден краток историски осврт на институцијата брак и постапката за склучување на бракот. Потоа во посебно поглавје се третираат некои општи поими поврзани со институцијата брак како што се: поимот брак, условите за склучување и правосилност на бракот, правната постапка за склучување на брак, обврските на брачните другари и многу други аспекти на институтот брак. Тезата продолжува понатаму со третирање на последиците од склучувањето на бракот, што го сочинува и главниот предмет на овој труд, каде што детално се анализираат личните, неимотните, како и имотните последици од бракот. За реализација на целта на трудот се потпревме на користењето на следните главни методи на истражување: методот на анализа, доктринарниот (дескриптивен) метод и во некои случаи и споредбениот и историскиот метод.

Клучни зборови: брак, лични последици од бракот, имотни последици од бракот, постапка за склучување на брак, итн.

Falenderime :

Pas përfundimit të këtij punimi, nuk do kisha bërë dot asgjë pa ndihmën e personave të duhur në jetën time. Është kënaqësi e imja që kam patur mundësinë të jem në këtë Universitet dhe kam mundur të angazhohem në një punim shkencor për të marrë një titull nga një institucion arsimor i vlerësuar për merita të mëdha.

Në çdo hap jam ndjekur dhe përkrahur nga udhëheqësja ime, e nderuara Prof. Albana Metaj-Stojanova. Kam gjetur tek ajo jo vetëm dije, por edhe një shoqe të mirë, e cila nuk ka reshtur së ndihmuari edhe jashtë orarit të punës. Një falënderim i veçantë shkon për familjen time, pa mbështetjen e së cilës kjo ndërmarrje e rëndësishme dhe përfundimi i këtij disertacioni do të kishte qenë i pamundur.

Përkushtimi, mbështetja dhe dashuria e familjes sime më ka dhënë forcë, ambicie dhe vullnet që unë të realizoj me sukses studimet.

Mirënjohje !

STRUKTURIMI I PUNIMIT

Deklaratë e autorsisë	2
Abstrakt	3
Abstract	4
Анстракт	5
Hyrje	10
Lënda e hulumtimit.....	11
Qëllimet e hulumtimit	13
Hipotezat	15
Metodologjia e hulumtimit	16
Rëndësia e hulumtimit	17

Kapitulli I

I. ZHVILLIMI HISTORIK, KUPTIMI DHE NATYRA JURIDIKE E MARTESËS

1.1 Zhvillimi historik i martesës.....	18
1.2 Martesa në të drejtën romake.....	22
1.3 Martesa në të drejtën zakonore shqiptare.....	25
1.4 Martesa bashkëkohore.....	27
1.5 Kuptimi i institutit të martesës.....	29
1.6 Natyra juridike e institutit të martesës.....	31
1.7 Parimet e të drejtës martesore	32
1.7.1 Parimi i barazisë.....	33
1.7.2 Parimi i laicitetit.....	33

1.7.3 Parimi i institucionalitetit.....	34
1.7.4 Parimi i monogamisë.....	34
1.7.5 Parimi i jetës së vazhdueshme.....	35

Kapitulli II

II. PROCEDURA PËR LIDHJEN E MARTESËS

2.1 Kushtet themelore për lidhjen e martesës.....	37
2.1.1 Pajtimi i vullneteve të bashkëshortëve për lidhjen e martesës.....	38
2.1.2 Gjini të ndryshme.....	39
2.1.3 Forma për lidhjen e martesës.....	40
2.2 Pengesat martesore.....	41
2.3 Procedura për lidhjen e martesës.....	43
2.3.1 Procedura paraprake.....	44
2.3.2 Lidhja e martesës përpara organit kompetent.....	45

Kapitulli III

III. PASOJAT PERSONALE JO PASURORE TË LIDHJES SË MARTESËS

3.1 Përcaktimi i mbiemrit të bashkëshortëve.....	47
3.2 Zgjedhja e punës dhe profesionit.....	48
3.3 Zgjedhja e vendbanimit të përbashkët të bashkëshortëve.....	49
3.4 Jetesa e përbashkët e bashkëshortëve.....	50
3.5 Kontributi në plotësimin e nevojave të familjes.....	50
3.6 Detyrimi për besnikëri bashkëshortore	52
3.7 Detyrimi për ndihmë morale.....	53
3.8 Të drejta dhe detyrime të parashikuara në akte të tjera normative.....	54

3.8.1 Fitimi i zotësisë për të vepruar si rezultat i martesës.....	55
3.8.2 Fitimi i shtetësisë si rezultat i martesës.....	57

Kapitulli IV

IV. PASOJAT PASURORE TË LIDHJES SË MARTESËS

4.1 Marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve.....	59
4.1.1 Regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.....	61
4.1.2 Puna si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.....	64
4.1.3 Sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve.....	64
4.1.4 Administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët.....	66
4.1.5 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve.....	70
4.1.6 Sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave personale të njërit prej bashkëshortëve.....	71
4.1.7 Administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë.....	72
4.1.8 Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore.....	73
4.2 Detyrimi për mbajtje midis bashkëshortëve.....	74
4.3 E drejta e trashëgimisë ligjore.....	76
Përfundime dhe rekomandime.....	78
Literatura e shfrytëzuar.....	81

HYRJE

E drejta për të lidhur martesë është pjesë përbërëse e **lirive themelore** të individit. Kur flasim për martesën dihet që ajo është bashkëjetesa ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, e cila lidhet me ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza të unitetit në familje. Sipas nenit 6 të Ligjit për familjen: Martesa është bashkësi jete e rregulluar me ligj, midis një burri dhe një gruaje, në të cilën përmbushen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë sëbashku me qëllim të krijimit të familjes. Martesa është marrëdhënie e vazhdueshme sepse mund edhe të zgjidhet me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e njërit nga bashkëshortët e zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e saj. Në këtë punim do të shqyrtojmë pasojat që lindin për bashkëshortët nga momenti i lidhjes së martesës, si pasojat apo efektet personale, jo pasurore të martesës, ashtu dhe efektet pasurore që lindin për bashkëshortët nga çasti i lidhjes së martesës. Kontrata martesore është një marrëveshje e lidhur para ose gjatë martesës, nga bashkëshortët duke përcaktuar në të regjimin pasuror martesor që ata dëshirojnë të aplikojnë për pasurinë e tyre, ndryshe nga çfarë ligji parashikon. Ky është një institut juridik novator, i nxitur nga fenomeni social i konfliktit ndërmjet bashkëshortëve, për të përcaktuar destinacionin e pasurisë së vendosur gjatë martesës. Nga ana tjetër, legjislacioni ofron mundësinë e mbrojtjes së pasurisë së secilit bashkëshort, pa u kushtëzuar nga instituti i martesës dhe njëkohësisht pa humbur kjo e fundit funksionin fillestar. Në periudhat më të hershme, kjo lloj kontrate është trajtuar si mjet juridik për të mbrojtur pasuritë e grave, nisur nga fakti se, në momentin që gruaje martohej me bashkëshortin e saj të ardhshëm, gjithë pasuria e saj kalonte në duart e bashkëshortit.

LËNDA E HULUMTIMIT

Martesa është burim kryesor i familjes. Martesa është bashkim juridik i dy personave të gjinive të ndryshme, të cilët synojnë një jetesë të përbashkët dhe realizim të përbashkët të interesave personale dhe pasurore, duke formuar kështu një bashkësi në drejtim të kontributit dhe mbarëvajtjes së familjes. Lidhja e martesës sjell për bashkëshortët një sërë të drejtash dhe detyrimesh. Tërësia e të drejtave dhe detyrimeve përfaqësojnë përmbajtjen e marrëdhënies martesore. Këto të drejta e detyrime në masë të madhe janë rregulluar me norma urdhëruese nga Ligji për Familjen. Në këto rrethana, bashkëshortët nuk mund t'i shmangen përmbushjes së tyre, as me marrëveshje ndërmjet tyre, e aq më pak nëpërmjet vullnetit të njëanshëm të njërit bashkëshort. Pasojat e martesës lindin automatikisht nga fakti i lidhjes së martesës. Në këtë kuptim, bashkëshortët janë të lirë të lidhin ose jo martesë, por nëse japin pëlqimin për lidhjen e saj, nuk mund të parashikojnë zbatimin vetëm pjesërisht të këtyre pasojave, ndryshimin apo shmangien e tyre. Kuadri ligjor bazë që rregullon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesa është Ligji për Familjen. Megjithatë, këto të drejta e detyrime mund të parashikohen dhe nga ligje të tjera të posaçme.

Martesa është një institut që sjell pasoja jo vetëm mbi shumë nga institutet e së drejtës civile, si për shembull zotësia për të vepruar, trashëgimia, aktet e gjendjes civile, etj., por dhe në degë të tjera të së drejtës. Mund të përmendim këtu të drejtën e sigurimeve shoqërore apo të drejtën penale, ku cilësia e bashkëshortit ndikon në shfaqjen e pasojave të caktuara të parashikuara nga legjislacionet përkatëse. Megjithatë, në fokus të këtij punimi janë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesa e që janë parashikuar kryesisht nga Ligji për Familjen në Maqedoninë e Veriut. Nga ana tjetër, një numër i caktuar të drejtash e detyrimesh nuk mund të rregullohen me norma juridike, pasi kanë të bëjnë me gjendjen psikologjike apo biologjike të secilit bashkëshort, aspekte që kanë të bëjnë me sferën private e intime të çdo personi.

Prandaj, këto lloj marrëdhëniesh realizohen spontanisht e vullnetarisht, pa qenë nevoja të parashikohen si detyrime ligjore. Detyrimet e parashikuara shprehimisht në Ligjin për

Familjen përbëjnë një “model minimal të jetës midis bashkëshortëve”. Pra, ligjvënësi nuk ka pretenduar të përcaktojë me përpikmëri përmbajtjen e gjithë detyrimeve martesore. Në këtë punim do të përqëndrohemi kryesisht në efektet e martesës që parashikohen në Ligjin për Familjen, ku më të rëndësishmet janë:

- Pasojat personale jo-pasurore dhe
- Pasojat pasurore.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të bëjë një analizë thelbësore të institutit të martesës, dhe të drejtave dhe detyrimeve martesore, sepse jo të gjithë jemi të njohur me pasojat e lidhjes së martesës, pra me të drejtat e detyrimet që burojnë prej saj. Ky hulumtim e vendos theksin tek të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, realizimi i të cilave është shumë me rëndësi për mbarëvajtjen dhe funksionimin e lidhjes martesore. Në këtë punim do të përshkruhet zhvillimi historik i martesës, si një institut kryesor i së drejtës familjare, por i së drejtës në përgjithësi, duke filluar nga martesë në të drejtën romake, martesë në të drejtën zakonore shqiptare, e rregulluar me normat zakonore të kanuneve të ndryshme e deri tek martesë bashkëkohore që njohim sot. Do të analizohet gjithashtu natyra juridike e martesës dhe parimet kryesore të së drejtës martesore bashkëkohore. Në punim do të pasqyrohet dhe procedura e lidhjes së martesës në RMV. Më tej, punimi ka për qëllim të analizojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, të parashikuara në Ligjin për Familjen të RMV-së.

Do të analizohen të drejtat dhe detyrimet me pasoja personale, jo pasurore, siç janë: përcaktimi i mbiemrit të bashkëshortëve, zgjedhja e punës dhe profesionit, zgjedhja e vendbanimit të përbashkët të bashkëshortëve, jetesa e përbashkët e bashkëshortëve, kontributi në plotësimin e nevojave të familjes dhe ndalimi i çdo lloj dhune në marrëdhëniet martesore e familjare. Do të trajtohen gjithashtu dhe të drejta dhe detyrime të tjera që kanë të bëjnë me sferën intime të bashkëshortëve e që nuk janë të rregulluara me ligj, siç janë: detyrimi për besnikëri bashkëshortore dhe detyrimi për ndihmë morale. Po ashtu, do të analizohen dhe të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve me pasoja pasurore, ku bëjnë pjesë: marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe detyrimi për mbajtje ndërmjet bashkëshortëve. Ky punim nuk ka për qëllim të analizojë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga prindëria, por vetëm ato të drejta dhe detyrime që janë pasojë imediate e lidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve. Në këtë punim do të paraqiten shkurtimisht dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve që janë të parashikuara nga akte të tjera normative, si për shembull: fitimi i zotësisë për të vepruar si rezultat i martesës, fitimi i shtetësisë, detyrimi i deklarimit të pasurisë,

fitimi i trashëgimisë ligjore, etj. Qëllimi kryesor i këtij punimi është analizimi i rregullimit ligjor të drejtave dhe detyrimeve që lindin midis bashkëshortëve nga çasti i lidhjes së martesës, si ato me pasoja personale, ashtu dhe ato me pasoja pasurore. Do të theksohet nevoja e lejimit të një autonomie më të madhe të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre nëpërmjet kontratës martesore.

Megjithatë, dinamika e marrëdhënieve familjare e martesore është e atillë, që përfshin një gamë shumë të gjerë marrëdhëniesh midis bashkëshortëve, ku shumë prej tyre kanë një karakter të theksuar personal e intim, prandaj ligjvënësi kufizohet vetëm me rregullimin e detyrimeve të caktuara, që përbëjnë një “model minimal të jetës midis bashkëshortëve”. Është e pamundur që të rregullohen me ligj të gjitha aspektet e jetës martesore dhe një sërë marrëdhëniesh bashkëshortore realizohen spontanisht, pa qenë nevoja të jenë të përcaktuara si detyrime ligjore.

HIPOTEZAT

Hipoteza kryesore e këtij punimi është: - Për shkak të kompleksitetit të marrëdhënieve bashkëshortore, ligjvënësi e ka të pamundur të rregullojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet midis bashkëshortëve, sidomos ato që kanë të bëjnë me sferën private e intime të tyre, prandaj kufizohet në përcaktimin e modelit minimal të jetës midis bashkëshortëve. Hipoteza dytësore e këtij punimi është: - Bashkëshortëve duhet t'u lihet më tepër hapësirë për shfaqjen e autonomisë së vullnetit në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre, nëpërmjet njohjes dhe implementimit të kontratës martesore në legjislacionin e RMV-së.

Në këtë punim do të shtrohen pyetje kërkimore të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi në mënyrë joshteruese, të tilla si:

- Cili është kuptimi dhe natyra juridike e institutit të martesës?
- Si ka evoluar martesë që nga e drejta romake e deri në martesën bashkëkohore?
- Cila është procedura e lidhjes së martesës në Maqedoninë e Veriut?
- Cilat janë pasojat personale jo pasurore që lindin për bashkëshortët nga çasti i lidhjes së martesës?
- Cilat janë pasojat pasurore që lindin për bashkëshortët nga lidhja e martesës?
- A nevojitet një autonomi më e madhe e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre?
- Cilat janë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet bashkëshortëve që janë të parashikuara nga akte të tjera normative?

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi është si më poshtë:

Mbledhja dhe përpunimi i literaturës - Ky hap ka të bëjë me rishikimin e literaturës në lidhje me objektin e punimit. Këtu përfshihet identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, artikujve shkencorë të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën ligjore në përgjithësi dhe në fushën e temës në veçanti.

Analiza e legjislacionit - Në këtë punim do të mbështetimi në metodën e analizës dhe sintezës. Metoda ka të bëjë me formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në sistemin tonë juridik, normat ligjore që rregullojnë tematikën në fokus të punimit gjenden në Ligjin për Familjen dhe në ligje të tjera. Metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjedhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Metoda e analizës së legjislacionit është përdorur për interpretimin e dispozitave ligjore referuar të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga lidhja e martesës.

Metoda komparative - do të përdoret për krahasimin e modeleve të vendeve të ndryshme në aspekt të autonomisë së bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre nëpërmjet kontratës martesore. Metoda doktrinare do të përdoret për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme.

Metoda historike - Shfrytëzimi i kësaj metode ka për qëllim paraqitjen e evoluimit të institutit të martesës duke filluar nga e drejta romake, e drejta zakonore shqiptare e deri në ditët tona.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Ky punim synon të jetë një kontribut i vlefshëm në trajtimin e tematikës në fokus, duke vënë theksin tek të drejtat dhe detyrimet personale dhe pasurore që lindin ndërmjet bashkëshortëve nga lidhja e martesës. Një rëndësi të veçantë do të ketë dhe trajtimi i të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet bashkëshortëve që burojnë nga akte të tjera normative, përveç Ligjit për Familjen. Familja është një nocion mjaft i vjetër, që ka ekzistuar që nga fillimet e njerëzimit. Martesa vazhdon të ngelet baza kryesore e krijimit të familjes. Kujdesi gjatë përzgjedhjes së bashkëshortit dhe të bashkëshortes nuk është me rëndësi vetëm për lumturinë e vetë çiftit bashkëshortor, por edhe për vazhdimësinë dhe stabilitetin e mbarë familjes e shoqërisë. Njohja dhe realizimi i të drejtave dhe detyrimeve martesore nga ana e bashkëshortëve ndikon në ruajtjen e harmonisë dhe mirëkuptimit në marrëdhëniet bashkëshortore e familjare, ndërsa mos realizimi i të drejtave dhe detyrimeve bashkëshortore shpesh herë çon deri në shkurorëzim të martesës.

Në këtë punim do të shqyrtohet gjithashtu mundësia për njohjen e një autonomie më të madhe të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre, nën shembullin e legjisllacioneve të vendeve të zhvilluara, por edhe të praktikave pozitive të disa vendeve të rajonit. Kontrata martesore është një marrëveshje, e cila lidhet nga bashkëshortët para ose gjatë martesës, me të cilën ata vendosin të përzgjedhin regjimin pasuror martesor që dëshirojnë të aplikojnë për pasurinë e tyre, ndryshe nga regjimi pasuror që parashikon ligji.

Ky është një institut juridik novator, i nxitur nga fenomeni social i konfliktit ndërmjet bashkëshortëve, për të përcaktuar destinacionin e pasurisë së vendosur gjatë martesës, sidomos në rastet e shkurorëzimit.

KAPITULLI I

I. ZHVILLIMI HISTORIK, KUPTIMI DHE NATYRA JURIDIKE E MARTESËS

1.1 Zhvillimi historik i martesës

Martesa është një institut shumë i vjetër shoqëror që ka evoluar bashkë me shoqërinë njerëzore. Gjatë gjithë kohërave qenia njerëzore është shoqëruar nga instinkti i bashkimit të gjinive, bashkim ky i pranuar si nga parimet morale, ashtu edhe ato fetare. Edhe para ekzistencës së shoqërisë moderne, martesa nuk shihej vetëm si një akt personal dhe privatë, por konsiderohej një akt me interes publik. Martesa ka ekzistuar për mbi 4000 vjet, por provat më të hershme për zhvillimin e ceremonive martesore i përkasin vitit 2350 p.e.s. dhe janë gjetur në Mesopotami.

Në të kaluarën, në të ashtuquajturën *familje tradicionale* në vendet evropiane, në periudhën nga shek. XVI-XVIII martesa ka pasur disa karakteristika kryesore, si p.sh. ndikimi i fuqishëm i fesë, dominimi i burrit në marrëdhëniet martesore dhe familjare, pozitë e nënshtruar e gruas në martesë, mos ekzistenca e barrierave midis familjes dhe bashkësisë lokale, etj.¹

Kisha dhe institucionet fetare në përgjithësi, kishin rolin kryesor në rregullimin e martesës dhe marrëdhënieve familjare në shumicën e vendeve evropiane deri në reformat protestante. Martesa ishte një lidhje e pazgjdhshme (sipas Biblës ajo që lidhej nga Zoti nuk mund të ndahej nga njeriu). Në raste të caktuara, kisha mund të lejonte ndarjen e partnerëve martesorë, por ata nuk kishin më të drejtë të lidhnin martesë të re. Gjyqet kishtare ishin kompetente për të gjitha çështjet e lidhura me martesën. Pas reformave protestante filloi një luftë e ashpër për kompetencën e rregullimit të marrëdhënieve martesore dhe familjare dhe mundësinë e zgjidhjes së martesës. Protestantët besonin se martesa ishte institut njerëzor, shoqëror dhe jo një institut i shenjtë, siç ishte qëndrimi i Kishës Katolike. Filloi një reformë e gjerë në vendet protestante, ku rregullimi i martesës dhe marrëdhënieve familjare kaloi në kompetencë të organeve shtetërore, ndërsa zgjidhja e konflikteve kaloi në kompetencën e gjykatave

¹ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 21

shtetërore. Filloi të lejohet shkurorëzimi në rast të tradhëtisë bashkëshortore apo në rastin e braktisjes së banesës familjare nga ana e njërit bashkëshort.²

Në periudhën e ekzistencës së familjes tradicionale në vendet evropiane martesat lidheshin për plotësimin e interesave ekonomike të familjeve, dhe jo në bazë të dashurisë midis të rinjve, ndërsa struktura e familjes ndryshon ndjeshëm nga ajo e familjes bashkëkohore sepse në familje nuk jetonin vetëm bashkëshortët, por edhe të afërm të tjerë. Jeta intime familjare dhe martesore nuk ekzistonte sepse njerëzit jetonin në kolektiv, pa u veçuar në ambiente të posaçme. Në bashkësi jetonin, prindërit, fëmijët, si dhe shërbëtorët e tyre, ndërsa shtëpitë ishin të hapura për fqinjët, të afërmit dhe miqtë.³

Martesa në vendet evropiane lidhej për plotësimin e nevojave pasurore dhe interesave politike të familjes, dhe jo për arritjen e lumturisë personale të bashkëshortëve. Zgjedhjen e bashkëshortit e bënin prindërit dhe familjarët. Ndërsa sot, në shoqërinë moderne, dashuria është baza për lidhjen e martesës, dhe jo interesat pasurore. Ky është një nga dallimet kryesore midis shoqërisë tradicionale dhe asaj moderne.

Në shoqërinë tradicionale ekzistonte një renditje e rreptë hierarkike në të gjitha marrëdhëniet shoqërore. Nga kjo nuk bënte përjashtim as familja, ku burri kishte rolin e patriarkut. Pushteti i burrit në martesë dhe familje ishte pothuajse absolut. Burri e përfaqësonte familjen në publik dhe ishte përgjegjës për sjelljen e të gjithë anëtarëve të familjes. Gruaja duhej të ishte besnike, ta dëgjonte dhe respektonte burrin dhe të jetonte në vendin e përcaktuar nga burri. Gratë ishin tërësisht të përjashtuara nga jeta publike. Pas lidhjes së martesës, gruaja gjendej në pozitën juridike të fëmijës së mitur, ndërsa kujdestar i gruas ishte bashkëshorti i saj.⁴

Po ashtu, në periudhën para-industriale në Evropë ekzistonte një ndarje gjinore e punëve, kështu që burrat dhe gratë asnjëherë nuk bënin punë të njëjta. Gratë kujdeseshin për punët e amvisërisë dhe konsideroheshin si “makineri për prodhimin e fëmijëve” dhe si të tilla trajtoheshin - në mënyrë mekanike dhe pa ndjenja.

Me zhvillimin e shoqërisë, nën ndikimin e industrializimit, u arrit transferimi i disa funksioneve të familjes në institucione të tjera shoqërore (shkolla, çerdhe, spitale, etj.) dhe u zhvilluan

² Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 29-30

³ Idem, fq. 22-23

⁴ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 23-24

lidhjet e ngushta emotive midis bashkëshortëve dhe midis prindërve dhe fëmijëve. Këto janë ndryshimet më kryesore që kanë ndodhur në jetën martesore dhe familjare.

Në shoqërinë moderne një ndryshim i rëndësishëm është edhe lidhja e martesës në bazë të dashurisë, simpatisë reciproke, ku lidhja dhe afrimiteti midis bashkëshortëve zënë një rol kryesor dhe madje përbëjnë bazën e vetme për lidhjen e martesës. Po ashtu, në dallim me familjen tradicionale të së kaluarës, familja mbyllet ndaj komunitetit, dhe kthehet në vend intim, privatë, në të cilin qasja e personave të jashtëm është shumë e kufizuar. Kështu, martesë dhe familja bëhen qendra më e rëndësishme e jetës së njerëzve.

Reforma protestante dhe shkolla e të drejtës natyrore ndikuan në formimin e konceptit modern për martesën, sipas të cilit martesë përfaqëson një kontratë civile që duhet të rregullohet nga organet shtetërore dhe jo nga organet religjioze. Koncepti i martesës si kontratë dominoi dhe pas Revolucionit francez, ku në Kushtetutën e Francës të vitit 1791 në mënyrë eksplicite thuhet se "Ligji e konsideron martesën si kontratë civile". Një nga pasojat juridike më të rëndësishme të pranimit të konceptit kontraktues për martesën është dhe mundësia e shkurorëzimit të martesës. Nëse martesë është kontratë, që lidhet me shprehjen e lirë të vullnetit të të dy bashkëshortëve, atëherë, si të gjitha kontratat e tjera, duhet të parashikohet edhe mundësia për zgjidhjen e kësaj kontrate. Megjithatë në vendet me ndikim të madh të Kishës Katolike, shkurorëzimi fillon të praktikohet vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të XX. Kështu, në Itali divorci ka qenë i ndaluar deri në vitet '70-të të shekullit të XX. Më gjatë divorci ka qenë i ndaluar në Irlandë, ku është ndaluar deri në vitin 1995.⁵

Pranimi i karakterit kontraktues të martesës nuk do të thotë se liria e bashkëshortëve është e pakufizuar. Martesë është kontratë, por njëkohësisht dhe institut juridik dhe social shumë i rëndësishëm. Kushtet për lidhjen e martesës, procedura për lidhjen e martesës, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, mundësia për shkurorëzimin e martesës, të gjitha këto çështje rregullohen me ligj.

Megjithatë karakteri kontraktues i martesës nuk duhet ngatërruar me kontratën apo marrëveshjen martesore që njihet si një marrëveshje e lidhur para ose gjatë martesës nga bashkëshortët e ardhshëm e cila dihet që ka për qëllim për të përcaktuar në të regjimin pasuror

⁵ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 31

martesor që ata dëshirojnë të shfrytëzojnë për pasurinë e tyre, *ndryshe nga parashikimet në ligjin aktual mbi këtë çështje*. Ndërkohë një përkufizim mjaft modern është ai se *kontrata martesore është një meditim për divorcin, duke i paraprirë çdo konflikti të mundshëm pasuror me anë të saj*.⁶

Në kohërat më të hershme kjo lloj kontrate (marrëveshje) është trajtuar si një mjet juridik për të mbrojtur pasuritë e grave, duke e ditur se gruaja i kalonte pasuritë e saj në pronësi të bashkëshortit. Megjithatë gjatë rrugëtimit, pra në vijim kontrata e martesës mori dhe zhvillim të mëtejshëm dhe zgjerim të dukshëm. Përdorimi i saj, forma e përmbajtja dukshëm pësuan ndryshime të mëtejshme duke ecur paralelisht me institutet e tjera të së drejtës. Kjo fal ligjeve që sjell shteti e që janë për të mirën e të dy bashkëshortëve. Gjithashtu, në ndryshimin e kontratës së martesës ka ndikuar edhe vetë martesja, shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe mënyra se si bashkëshortët kanë mësuar t'i paraprijnë këtij konflikti.

Kur flasim për ecurinë e këtij procesi, në shtetet e Evropës në sistemin *Civil Law*, *gjurmët e para të kontratës së martesës si një akt i mirëfilltë i gjejmë në Francë në fund të shekullit XIX, e cila është vlerësuar si paradoks për sa i përket faktit se Franca njihte barazinë gjinore që në vitin 1789, ndërkohë nuk i njihte gruas pavarësinë ekonomike*.⁷

Një tjetër konventë e cila njihet botërisht e që daton shumë kohë më parë është edhe ajo e Hagës. *Në vendet e Evropës është me mjaft rëndësi edhe Konventa e Hagës, e datës 14 Mars të vitit 1978, ku Holanda, Franca dhe Luksemburgu miratuan këtë Konventë për regjimet e martesës sipas të cilës përcaktohej në mënyrë të detajuar se si bashkëshortët mund të rregullojnë me marrëveshje regjimin pasuror ndërmjet tyre*.⁸ Evoluimi i cili ka bërë kjo konventë është mjaft i dukshëm.

Një interes të veçantë, paraqet dhe rasti i Greqisë, ku kontrata martesore u mundëson bashkëshortëve të përcaktojnë në mënyrë të lirë destinacionin e pasurive të tyre, si dhe pa qënë të kushtëzuar nga lidhja e martesës. Këtë marrëveshje e kanë quajtur si marrëveshje

⁶ Alexander, G.S. "The New Marriage Contract and the Limits of Private Ordering". Indiana Law Journal. Vol 73 (1998), 503-510.

⁷ Nicolas F, Marion L, "Wealth, marriage and prenuptial agreements in France (1855 - 2010)" 2018, vol. 68, çështja C, 132-142

⁸ Boiche A, (2007) "Marriage Contract and prenuptial agreement in French Law", Paris, faqe 5

paramartesore dhe e kanë aplikuar gjithmonë e më shumë në realizimin e regjimeve pasurore ndërmjet bashkëshortëve. Në Francë dhe Belgjikë këto marrëveshje paramartesore duhet të krijohen në praninë e një noteri, sepse formaliteti i këtij veprimi juridik nuk ka rëndësi vetëm për bashkëshortët me njëri-tjetrin, por edhe për publicitetin e veprimit juridik në lidhje me të tretët. *Ligji duhet të kujdeset gjithmonë për mbrojtjen e të tretëve.*

1.2 Martesa në të drejtën romake

*E drejta romake është e para që hedh idenë e martesës si kontratë.*⁹ Në të drejtën romake për të bërë një martesë me pasojat ligjore përkatëse, ishte e nevojshme që çifti të plotësonte disa kushte. Vetëm një nga këto kushte ishte absolute dhe duhej të ishte në dispozicion për lidhjen e çdo martese romake. Kushtet e tjera praktikisht luanin rolin e kushteve relative, prania e të cilave ishte e nevojshme për martesën midis personave që i përkisnin grupeve të ndryshme shoqërore.

Martesa me manus ishte karakteristike në të drejtën e lashtë romake. Në periudhën më antike, gruaja dilte nga familja e saj, pra nga *pater potestas*-i i *pater-familias*-it të saj, dhe hynte në familjen agnate të burrit si e nënshtruar ose ndaj pushtetit të burrit (*manus*), ose ndaj pushtetit të *pater-familias*-it të burrit (në rastin kur burri ishte *alieni iuris*). Në rast se gruaja ishte person *sui iuris*, me lidhjen e martesës, tutoria mbi të pushonte dhe ajo kthehej në person *alieni iuris*.¹⁰

Një regjim mjaft i njohur në këtë periudhë është edhe ai dotal. Në modelin e martesës "*matrimonium sine manus*", regjimi pasuror martesor përbëhej nga dy elemente: dota dhe pasuria "*donazione ob nuziale*", e njohur si pasuria që bashkëshorti i dhuron gruas në momentin e lidhjes së martesës. Në vazhdim, në mënyrë më të zgjeruar do të shohim karakteristikat që parashikoheshin në lidhje me këto dy elemente të regjimit dotal nga e drejta romake. E megjithatë, liria në përcaktimin e regjimit pasuror bashkëshortor nuk mund të jetë asnjëherë absolute si në kontratat e tjera që njohim. Liria kontraktuale, në kuptimin e regjimit pasuror bashkëshortor, nuk mund të jetë e pakufizuar, por ajo duhet të pësonte disa kufizime,

⁹ Zaçe, V. (1996). Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Shtëpia Botuese Logoreci, Tiranë, fq. 43.

¹⁰ Ken Dhima, E drejta romake, Tiranë, 2011, fq. 439

të cilat shteti i konsideronte të nevojshme për një organizim më të shëndoshë të familjes. *Dota ishte pasuria që gruaja ose të tjerët në vend të saj ia jepnin burrit për të përballuar shpenzimet që do të vinin nga martesë.*¹¹ Nëse në kontratën e martesës, objekti i pasurisë dotale ishte i rregulluar me fjalët “gjithë pasuria e gruas”, atëherë në dotë do të përfshihej vetëm pasuria e tashme e saj dhe jo ajo e ardhshme.¹² Veçimi i dotës kishte mundësi të kërkohej nga gruaja edhe kur ishte vendosur veçimi personal për faj të bashkëshortit, ose të të dyve. Ndërsa kur gjykata e vendoste veçimin e dotës, gruaja detyrohej të kontribuonte sipas fuqisë ekonomike të saj në shpenzimet familjare, në përkujdesin dhe edukimin në veçanti të fëmijëve të tyre.

Pra në këtë rast gruaja merrte administrimin e lirë të pasurisë së saj. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Diktimit për sa i përket dotës kryesisht është e lidhur me veçimin e dotës ose ndikimin e saj në marrëdhëniet me të tretët. Martesa në Romën e lashtë mbi të gjitha ishte një institucion rreptësisht monogamë. Një qytetar romak sipas ligjit mund të kishte vetëm një bashkëshort/e në të njëjtën kohë. Praktika e monogamisë dukshëm i dalloi grekët dhe romakët nga qytetërimet e tjera të lashta, në të cilat meshkujt e elitës në të shumtën e rasteve kishin shumë bashkëshorte. Monogamia greko-romake me shumë gjasa mund të ketë lindur nga egalitarizmi i sistemeve politike demokratike dhe republikane të qyteteve-shtete. Ky ishte një aspekt i kulturës së lashtë romake që u pëlqye nga krishtërimi i hershëm, i cili nga ana e tij e përjetësoi atë si një ideal në kulturën perëndimore.¹³

*Sipas ligjit të hershëm romak, mashkulli më i vjetër i gjallë ishte udhëheqesi i një familjeje dhe kishte autoritet absolut mbi anëtarët e tjerë të familjes. Kështu, familja e tij u kuptua se ishte nën udhëheqjen e tij.*¹⁴ Në këtë kulturë, ai kishte të drejtën dhe detyrën të kërkonte një partner të mirë dhe të dobishëm për fëmijët e tij dhe mund të organizonte fejesën e një fëmije shumë kohë përpara se ai ose ajo të arrinte moshën e pjekurisë.

¹¹ Kodi Civil i vitit, 1929, nenet 1331-1360.

¹² Po aty neni 1332.

¹³ Scheidel, Walter (2006) "Population and Demography," *Princeton/Stanford Working Papers in Classics*, fq. 7.

¹⁴ Bruce W. Frier and Thomas A.J. McGinn, *A Casebook on Roman Family Law* (Oxford University Press, 2004), fq. 20.

Për të çuar përpara interesat e familjeve të tyre të lindjes, djemtë e elitës duhet të ndiqnin baballarët e tyre në jetën publike, dhe vajzat duhet të martoheshin në familje të respektuara. Nëse vajza mund të provonte se burri i propozuar kishte karakter të keq, ajo mund të refuzonte në mënyrë legjitime martesën.

Martesa pa manus ishte karakteristike në të drejtën klasike e post-klasike romake, dhe u kthye në rregull nga fundi i Republikës, rreth shekullit të 1 p.e.s. Në martesën pa manus, pozita juridike e gruas nuk ndryshonte. Ajo mbetej e huaj për familjen agnate të burrit, nuk vendosej nën pushtetin e tij ose të *pater familias*-it të tij, e megjithëse e martuar, vazhdonte të ruante përkatësinë ndaj familjes së saj të mëparshme. Pra, ajo vazhdonte të mbetej nën pushtetin e pater-it të familjes së origjinës, e nëse ishte person *sui iuris*, tutoria mbi të nuk pushonte. Me lidhjen e martesës, gruaja ruante të drejtën e trashëgimisë në familjen e saj të origjinës. Sa i përket marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve, mund të thuhet se kjo martesë nuk ka pasur ndonjë ndikim sepse ka vlejtur parimi i pasurisë së ndarë të bashkëshortëve. Nëse gruaja ishte *alieni iuris*, gjithë pasuria e saj i përkiste *pater familias*-it të origjinës, e nëse ajo ishte *sui iuris*, atëherë gjithë pasuria që ajo kishte para martesës, si dhe ajo e krijuar gjatë martesës, i takonte vetë gruas. Nëse ekzistonin dyshime lidhur me prejardhjen e pronësisë së gruas, atëherë vlente supozimi (*praesumptio Muciana*), se ajo këtë pasuri e kishte fituar nga burri. Pasuria e gruas, që nuk bënte pjesë në pajë, quhej pasuri paramartesore (*parapherna*) apo *extra dotem*. Kjo pasuri administrohej nga gruaja. Burri nuk kishte të drejtën e administrimit ose të përdorimit të *parapherna*-s.¹⁵

¹⁵ Ken Dhima, E drejta romake, Tiranë, 2011, fq. 446

1.3 Martesa në të drejtën zakonore shqiptare

E drejta zakonore e popullit shqiptar në tërësi është një dëshmi e gjallë historike dhe juridike e ndërgjegjes kombëtare. Ky është një tregues se në kushtet e mungesës së autoritetit shtetëror janë krijuar dhe zbatuar normat e së drejtës zakonore për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore mes njerëzve në fusha të ndryshme të jetës, ekonomisë, moralit, religjionit, raporteve sociale, atyre politike, penale e shumë çështjeve të tjera. Origjina e së drejtës zakonore është shumë e lashtë. Si institucion në shoqërinë e bashkësisë primitive me të drejtë ka vepruar fuqiptotë deri në krijimin e instituteve juridike shtetërore. Ekzistimi i Kanuneve në vetvete ishte shprehje e autonomisë lokale apo e një varësie pothuajse formale të krahinave dhe zonave të thella gjeografike, në të cilën autoriteti qendror perandorak e kishte të vështirë të zbatonte të drejtën e tij pozitive. Megjithatë, elemente të veçanta të kësaj trashëgimie të trashëguar apo krijuar në rrethana të imponuara /caktuara historike dhe në kushte specifike gjeografike, ku kjo e drejtë veproi, ndikoi edhe në ruajtjen e disa tipareve dhe elementeve të natyrës nacionale, kur përballë e kishim rrezikun e asimilimit të huaj.

Dihet që martesë është akti me anë të së cilës ndërtohet familja. Martesa ishte një institucion strategjik për familjet shqiptare gjatë kohës kur kanë vepruar kanunet. Këto doke të pashkruara, të padokumentuara, i jepnin çiftit përgjegjësi dhe detyrime. Njëherit detyrimet e burrit ishin të një karakteri përkujdesës, ato të gruas ishin të një karakteri fatkeqësisht të bindur dhe të nënshtruar. Një ndër kanunet që njihet në gjithë botën është ai i Lekë Dukagjinit. Kanuni i Lekë Dukagjinit ngarkon burrin dhe gruan me detyra të ndërsjella. *Burrit i duhet të kujdeset që familjes të mos i mungojë gjë, si dhe për ruajtjen e nderit të gruas.*¹⁶

Sipas Kanunit thuhet se burri e blen mundin e jetës së gruas, por jo vetë jetën e saj. Njëherit ai mundet ta rrahë gruan pa pasur probleme me Kanunin dhe familja e saj nuk mund të kërkojë shpërblimin e rrahjes. Duke cituar: *“Burri ka tagër me e kshillue e me qortue gruen, me e rrahë e me e lidhë gruen e vet, kur të mbrijë me ia përbuzë fjalën e urdhrin.”*¹⁷

¹⁶ Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999, f. 11.

¹⁷ Po aty f.21

Sipas këtij kanuni njihen katër mënyra të martesës:

1. Martesa me kurorë,
2. Martesa pa kurorë,
3. Martesa me grabitje,
4. Martesa në provë.

Por pavarësisht që njihen këto katër mënyra, vetëm njëra është ajo që pranohet dhe ajo është mënyra e parë, ndërsa të tjerat janë jashtë kanunit. Kjo bëhet e qartë në nenin 29 të këtij kanuni. Rregullat e martesës dhe jetës bashkëshortore në këtë kanun janë patriarkale. Djali dhe vajza deri sa t'i kenë gjallë prindërit nuk kanë të drejtë asesi të vendosin apo të flasin për fatin e martesës. E nëse djali nuk i ka prindërit gjallë atëherë ai vendos vetë për martesë. E drejta e vajzës për fatin e saj sipas Kanunit është edhe më e vështirë, ngase asaj i merret çdo e drejtë për martesën e saj, pa marrë parasysh se a i ka prindërit të gjallë apo jo. Fati i saj nuk vendoset nga ajo, por është në dorën e vëllezërve dhe kushërinjëve të saj. Pavarësisht gjithë këtyre mangësive që ka ky kanun, nëse flasim për kohën kur ishte zbatuar ai ishte Ligj fuqiplotë, dhe ndëshkohej çdonjëri që nuk e zbatonte.

Një tjetër kanun i njohur ishte ai i Labërisë. *Që në fillim të kapitullit të martesës, te Kanuni i Labërisë sanksionohet se ajo bëhet sipas vullnetit të kryefamiljarëve të dy familjeve respektive.*¹⁸ Moshë për martesën e vajzave ishte 14-16 vjeçe, por, nëse ka zhvillim trupor, mund të ishte edhe 12 vjeçe. Ndërsa për djemtë ishte 16-20 vjeç. Sipas këtij Kanuni, njihen tri forma të martesave:

1. Martesat me kurorë,
2. Martesat me shpërblim,
3. Martesat me grabitje.

Lloji i parë vetëm se kuptohet nga titulli, që duhet vënë kurorë, por tërheq vëmendje lloji i dytë dhe i tretë. Te lloji i dytë i martesës kishte rëndësi shpërblimi në para ose në natyrë që merrte familja e vajzës. Ky shpërblim jepej për rrobat e nuses dhe për dhënien e vajzës. Sasia

¹⁸ Kanuni i Labërisë, 2006, f. 104.

e këtij shpërblimi përcaktohej me marrëveshje mes kryefamiljarëve. Sipas llojit të tretë të martesës, pra tek martesë me rrëmbim, djali merrte me vete krushq të armatosur, që rrëmbenin nusen pa vullnetin e saj. Quhej ofendim i madh mospranimi i saj për martesë. Ndërsa fenomen mjaft të rëndësishëm e që praktikohesh shpesh përbënin rastet kur pas martesës gruaja mbetej pa burrë për shkak të kurbetit. Gruaja, që i shkonte burri në kurbet, detyrohej të qëndronte në shtëpinë e tij dhe t'u bindej urdhrave të vjehrrit dhe kunetërve. Shkelja e besnikërisë bashkëshortore quhej krim i rëndë dhe sillte vdekjen e gruas. Burri, ashtu si në kanunet e tjera, kishte të drejtë të qortojë, rrahë e lidhë gruan kur ajo nuk i bindej. Pasuria bashkëshortore ishte po ashtu në duart e burrit.

Në kanunin që përdorej në Dibër, martesë përkufizohej kështu: *“Për vashën domethënë me lanë vajzën e me u ba grue, me vu ‘rrethin e hekurt kresë’, me humb një pjesë të liris’ e me iu ba petkë burrit e me iu përshtat njerëzve të tij”*.¹⁹ Ky kanun u lejonte burrave më shumë se një grua, kjo për arsye trashëgimtarësh. Në periudhën kur kanë vepruar këto kanune kishte shumë sëmundje dhe njerëzit vriteshin edhe për shkaqe të vogla, për këtë shkak, sa familjar aq edhe ekonomik, një burrë merrte dy ose më shumë gra, mbante gratë e vëllezërve, si dhe konsiderohej se po u bënte atyre një nder, pasi ato nuk rëndonin në ekonominë e familjes së babait.

1.4 Martesë bashkëkohore

Çdo njeri prej nesh, gjatë procesit të rritjes dhe zhvillimit na shfaqen shumë mënyra jetese. Shumë herë njerëzit vihen para një mëdyshje mjaft të madhe: të jetoj në krahët e dikujt, apo me veten?

Një numër shumë i madh i njerëzve e zgjedhin martesën si stilin më të parapëlqyer të jetës. Një numër i vogël rreth 6%-8% të tyre parapëlqejnë beqarinë dhe ky numër është në rritje të dukshme. Megjithatë është dhe një numër i konsiderueshëm individësh që sa vjen dhe shtohet, ndër ata që kërkojnë jetën në grup, bashkëjetesën me ose pa kontratë. Martesë e përditshme e njohur si tradicionale kërkon prej çiftit martesor vazhdimësi të detyruar dhe të

¹⁹ Kanuni i Dibrës, 2007, f. 259.

sigurt, flijim të individualitetit, e njohur me thënien “një shpirt në dy trupa“, pra është lidhje e përjetshme mbi interesat individuale. Kjo martesë kërkon mendim, emocion, sjellje, shprehi dhe mbijetesë të përbashkët identike. Vihen në pah shërbimet dhe ndihmesat e ndërsjella, të dhurohet dhe të merret nga partneri, partneritet i përjetshëm madje edhe pa dashuri, “afërsi“ maksimale formale. Në këtë marrëdhënie tolerohet pabarazia në marrëdhënie, dhe ka role të caktuara dhe të fiksuara.

Në martesën tradicionale mbizotërojnë monologët ku ka më pak dëgjim të dyanshëm. Të dy partnerët bashkëshortorë e dinë çfarë mendojnë, ndjejnë dhe çka do të thotë tjetri. Ndër ta ka edhe marrëdhënie të mbyllura, jo të singerta dhe jo të besueshme, një “ne” pa “unë” individual dhe të mëvetësishëm, një dukje e një shkrirjeje dhe afërsie të plotë, një ruajtje e një martese deri edhe formale, ku ka ndryshime shumë të pakta. Një gjë që bie në sy është përditshmëria monotone. Karakteristika e një martese të tillë është jeta monotone, e ritualizuar seksuale në martesë duke kërkuar pasion entuziast jashtë martese, dashuri jetëgjatë por monotoni bashkëshortore dhe dashuri jetëshkurtër, por entuziaste jashtëmartesore.

Martesa bashkëkohore kërkon një vazhdimësi të lirë dhe cilësore, një lidhje emocionale dhe seksuale, takime gjithmonë më të ndryshme, të veçanta dhe interesante brenda martesës. Këto çiftet martesore dëshirojnë të kenë mundësinë e ndarjes me mbetjen e lirë, përkujdesjen edhe për veten e jo vetëm për partnerin, një baraspeshë të asaj që është individuale dhe e përbashkët. Konfliktet dihet se janë pjesë përbërëse në çdo marrëdhënie të gjatë, prandaj ekzistojnë edhe mënyra të ndryshme të sjelljes ndaj tyre. Në një marrëdhënie të tillë çiftet mund të grinden për mirë ose keq, suksesshëm ose pasuksesshëm, konstruktivisht ose destruktivisht. Kjo gjendje i detyron ata që për grindjet të reflektojnë dhe të mundohen t'i bëjnë më të mira, cilësore, të suksesshme, e konstruktive dhe t'i shndërrojnë në shanse të përditshme të një njohjeje të ndërsjellë më të mirë.

Pothuajse në çdo konflikt duhet dalluar problemet që kanë sjellë deri te konflikti. Duhet të kuptohet gjendja emocionale e pjesëmarrësve të konfliktit, vështrimi dhe interpretimi personal i asaj çfarë ndodh gjatë konfliktit dhe sjellja evidente gjatë konflikteve. Nuk është krejt njëjtë se me çfarë ndjenjash i qasesh konfliktit, çfarë shihet dhe vërehet, se si interpretohet kjo. Të gjitha të lartëpërmendurat kanë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e konflikteve të

partnerit martesor dhe shpesh herë pikërisht ajo që më shumë e përcakton mënyrën e sjelljes së partnerit martesor me konfliktin, d.m.th. sjelljen e tij në konflikt, sesa faktet e rëndësishme që kanë sjellë deri te konflikti.

Dallimi kryesor midis martesës tradicionale dhe asaj bashkëkohore është barazia e bashkëshortëve në martesë, e cila është tipar dallues i martesës bashkëkohore, por ka munguar në martesën tradicionale. Bashkëshortët në martesën bashkëkohore janë të barabartë edhe si partnerë, edhe si prindër dhe kanë të drejta dhe detyrime të barabarta që burojnë nga martesë.

1.5 Kuptimi i institutit të martesës

Krejt në fillim të këtij punimi është me rëndësi të përkufizojmë nocionin e martesës.

Mund të themi me siguri se përkufizimi ligjor i martesës në veçanti ka një histori të gjatë, duke filluar me përkufizimin e përmendur si përkufizimi më i vjetër i martesës që daton në shekullin e IV pas Krishtit, i përcaktuar nga juristi romak Modestine, sipas të cilit "*Martesa është një marrëdhënie midis një burri dhe një gruaje, të bashkuar në jetën e përgjithshme, në të cilën ata ndajnë të gjitha gjërat e parashikuara nga e drejta hyjnore dhe njerëzore*".²⁰ Në veçanti "*Martesa është një bashkim i përherëshëm i jetës - tregon emocionet, anën psikologjike dhe ekonomike të martesës*".²¹ Kjo shenjë tregon se martesë bazohet në dashuri, mirëkuptim, respekt dhe ndihma e ndërsjellë e bashkëshortëve nuk arrihet vetëm nëpërmjet mbajtjes së marrëdhënieve seksuale. Në martesë të dy bashkëshortët përballen njëllor me të gjitha gëzimet, por edhe detyrimet që sjell ky bashkim.

Është shumë e rëndësishme të dihen karakteristikat e martesës dhe pozicioni që ka në legjislacion. Identifikimi i elementeve juridike bëhet gjatë krahasimit të parimeve të përgjithshme të institutit të martesës dhe karakteristikave të kontratave, në të drejtën e detyrimeve. Mjafton të sqarojmë se koncepti i martesës mund të përdoret njëllor për të dy rastet. Sipas nenit 6 të Ligjit për Familjen "*Martesa është një bashkësi jetese e rregulluar me ligj, midis një burri dhe një gruaje, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë*." Martesa hyn në kategorinë e veprimeve juridike të dyanshme, duke u nisur nga

²⁰Семејството во Европа XVI-XXI век, Дејан Мицковиќ, Културна установа Блесок, Скопје, 2008

²¹Семејно право во СФРЈ, Скопје, 1977, 1980 – Миле Хаџи Василев

koncepti i veprimeve juridike të dyanshme sipas doktrinës tonë.²² Në ligjin për familjen neni 19, qartë parashihet se martesë nuk bëhet me dhunë ose lajthim - *“Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme kur pëlqimi për lidhjen e martesës është dhënë nën ndikimin e dhunës ose lajthimit.”*²³ Pra kuptimi i këtij institucioni është që çdo gjë të jetë me dëshirë dhe e vullnetshme. Është e qartë se disa nga bashkëshortët që vendosin të martohen e kuptojnë rrugës rëndësinë e këtij instituti duke u njohur edhe me detyrimet që ata kanë në këtë bashkim. Sipas nenit 4 të Ligjit të familjes: *“Republika siguron mbrojtjen e martesës dhe familjes nga marrëdhëniet e prishura dhe dhuna në martesë dhe familje.”*²⁴

Megjithatë, ligji duhet njëjloj të angazhohet si për subjektet që duan të martohen dhe kanë shumë informacion nëpërmjet të cilit kërkojnë të rregullojnë çdo pasojë apo element juridik, i cili ndryshon nga lidhja e martesës, si dhe për ata që nuk kanë informacion, por vetëm në momentin kur hyjnë në marrëdhënie konfliktuale, atëherë kërkojnë që ligji t’u vijë në ndihmë për të zgjidhur kaosin social dhe juridik të krijuar mes tyre. Dhuna është një fakt i cili ndikon në dhënien e deklaratës së vullnetit me të meta.²⁵

*“E drejta martesore është një përmbledhje normash juridike me të cilat rregullohet martesë dhe marrëdhëniet martesore.”*²⁶ Prandaj themi se normat juridike me të cilat rregullohet martesë janë kryesisht të natyrës urdhëruese. Megjithatë përveç natyrës urdhëruese, ekzitojnë edhe shumë marrëdhënie të tjera martesore të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv të tilla si: marrëveshja që lidhet me mbiemrin, vendbanimi i përbashkët e shumë të tjera.

Për lidhjen shpirtërore si dhe për pasojat ligjore, janë dy gjëra me të cilat ligji nuk mund të kujdeset njëjloj për to, por mundohet të mundësojë alternativa të ndryshme në mënyrë që të realizohet sa më mirë e drejta në funksion të individit, për vetë faktin se nuk është detyrë e ligjit të arrijë të depërtojë edhe në këto dimensione mjaft të thella të njeriut. Megjithatë për nga

²² Nuni A, (2012) “Parime të përgjithshme të së drejtës Civile”, Tiranë, faqe 319

²³ ZAKOH 3A CEMEJTBOTO (LIGJI PËR FAMILJE)

https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osejstvo_osnoven.pdf

²⁴ ZAKOH 3A CEMEJTBOTO (LIGJI PËR FAMILJE)

https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osejstvo_osnoven.pdf

²⁵ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi E drejta familjare, 2007 fq.102

²⁶ Dr Nerimana Traljic Dr Suzana Bubic: “Porodico parvo”, Studentska stamparija Universiteta Sarajevo, fq 31.

natyra e zgjidhjeve që jep martesë, si dhe për vetë rezultatin që gjejnë bashkëshortët në këtë rast të ekzistencës së saj, qëllimet e martesës konkretizohen dhe do të mund t'i ndanim në tri grupe, shkak për të cilin është bërë e mundur që në ligjin tonë të kishim kontratën e martesës. Pra, martesë lidhet me pëlqim të lirë, përpara nënpunësit të gjendjes civile, mes një burri dhe një gruaje që ka mbushur moshën 18 vjeç. Thuhet se: Natyra juridike e martesës është mikse: ajo është një mirëkuptim dhe një dëshirë, pa të cilën nuk mund të ekzistojë, sepse që nga momenti i lidhjes së martesës bashkëshortët i nënshtrohen një statusi legal imperativ.²⁷ Duhet thënë se martesë është gjithashtu edhe institucion shoqëror, për shkak të karakterit të tillë, fati i saj nuk ka mundur të lihet vetëm në duart e burrit dhe gruas.

1.6 Natyra juridike e institutit të martesës

Sido që të jetë, për natyrën juridike të martesës ekzistojnë dy koncepte kryesore: martesë është kontratë civile, dhe martesë është institucion juridik.²⁸ Studiuesi italian Matteo Santini, e përkufizon martesën si një marrëveshje juridike që mund të lidhet vetëm mes personave të gjinive të ndryshme dhe përjashtojmë këtu rastet kur me autorizim të shprehur nga gjykata, martesë mund të lidhet edhe mes minoreneve që kanë mbushur vitin e gjashtëmbëdhjetë të jetës së tyre, pas verifikimit të pjekurisë psikike dhe fizike të duhur për të hyrë në një marrëdhënie juridike të tillë. Për t'ju kundërvënë këtyre qëndrimeve që vendosin shenjën e barazisë së martesës me kontratën, sjellim faktin se natyra juridike e saj është e papërputhshme me kushtet, të drejtat dhe detyrimet nëse nuk do të përshkohej nga ndjenja e dashurisë, respektit reciprok dhe qëllimit për të krijuar familje. Kjo rrymë është e mbështetur nga shkencëtarët siç janë Lefevre, Emanuel Levi, A. Bonkas, etj., të cilët kanë tentuar të shmangin ngurtësimin që ka rryma tjetër në lidhje me martesën pasi ata e arsyetojnë faktin se martesë nuk mund të ketë pasojat që ka një kontratë, nuk mund të materializohet qëllimi i krijimit të familjes deri në një formulë ligjore.²⁹ Ka një numër të madh hulumtimesh në doktrinën juridike që shpjegojnë natyrën juridike të martesës. Martesë, natyrisht, nuk mund të rregullohet plotësisht me ligj dhe pothuajse të gjithë shkencëtarët modernë dhe para-

²⁷ Frederique Granet: Le droit de la famille, presses Universitaires de Grenoble, 1997, fq.14.

²⁸ Hamdi Podvorica "E drejta familjare", Universiteti Iliria / Romina, Prishtinë, 2006, fq.67

²⁹ Zaçe, V.(1996). Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Shtëpia Botuese Logoreci, Tiranë, fq.45.

revolucionarë janë dakord me këtë. Është më e përshatshme që ligji të rregullojë marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve, por e pamundur të rregullohen marrëdhëniet personale e intime të tyre, edhe për shkak të gamës së gjerë të këtyre marrëdhënieve, të cilat në masë të madhe rregullohen nga vetë bashkëshortët në bazë të botëkuptimit, formimit, religjionit të tyre, etj. Sidoqoftë, një ndarje e tillë e marrëdhënieve që përbëjnë bashkimin martesor nuk u njoh menjëherë, por u desh kohë që të miratohet.

Në momentin kur kontrata synon kryerjen e një ose më shumë veprimeve, atëherë pasoja e saj me siguri do të jetë një marrëdhënie detyrimi, ndërsa bashkëjetesa retorike nuk nënkupton gjithmonë veprime të caktuara, por komunikim për jetën, ajo ka teorikisht, një moral dhe jo një përmbajtje ekonomike. Kështu, i njohuri G.F. Shershenevich njohu faktin juridik që krijon marrëdhënien e martesës si një kontratë, dhe vuri në pah disa ndryshime:

a) rrethi i “palëve kontraktuese” që lidhin martesë përcaktohet nga karakteristika tipike (mosha, shëndeti, gjinitë e kundërta, etj.);

b) rregullimi ligjor është projektuar për një numër të pakufizuar çështjesh të të njëjtit lloj.

Në literaturën juridike është shtruar shpesh pyetja nëse martesa përfshihet në kategorinë e kontratës, por duhet thënë se dallimet janë shumë thelbësore për t’i përfshirë të dyja në të njëjtën kategori.

1.7 Parimet e të drejtës martesore

Parimet themelore të së drejtës martesore, të cilat njëherit janë të vendosura në themelet e të drejtës martesore janë shumë të rëndësishme. Lista e këtyre parimeve themelore është:

- Parimi i barazisë ,
- Parimi i laicitetit ,
- Parimi i institucionalitetit ,
- Parimi i monogamisë ,dhe
- Parimi i jetës së vazhdueshme.

1.7.1 Parimi i barazisë

Gjatë historisë njerëzore gruaja i është nënshtruar një mori pabarazish në krahasim me burrin. Ajo i nënshtrrohej çdo gjëje që burri thoshte. Ishte burri ai i cili mbante pushtet të plotë mbi bashkëshorten dhe mbi pasurinë që posedonin, ndërsa e shoqja ishte e nënshtruar plotësisht dhe mbi të gjitha në një pozitë shumë diskriminuese. *"Kjo vlente për të gjitha shoqëritë e lashta të njerëzimit, siç ishin ajo indiane, greke dhe romake."*³⁰ Pushtetin mbi gruan në të drejtën romake gjithmonë e kishte burri. Gjatë evoluimit të shoqërisë njerëzore dhe me rregullimin ligjor të së drejtës familjare, kjo pozitë e gruas në familje dhe jo vetëm ka ndryshuar në masë të madhe. Ndryshimi filloi në dekadat e fundit të shekullit të kaluar. Sot të dy palët me ligj janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, në vazhdimësi, si dhe pas zgjidhjes së martesës. Parimi i barazisë qëndron në bazën e legjislacionit familjar të RMV-së. Ai është i shprehur në mënyrë eksplicite në disa nene të Ligjit për Familjen, si p.sh. në nenin 4, 6, 8, etj. Ky parim buron nga parimi kushtetues i barazisë midis qytetarëve, të cilët në RMV janë të barabartë në liri dhe të drejta, pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit politik dhe fetar, gjendjes pasurore dhe sociale.³¹

Askush nuk ka të drejtë që të diskriminojë tjetrin, sepse nuk ka detyrim që i përket vetëm njërit apo tjetrit (vetëm burrit apo vetëm gruas). Një mënyrë të veçantë zbatimi i këtij parimi është i rëndësishëm në zonat rurale, ku zhvillimi i marrëdhënieve në familje dhe barazia e burrit me gruan ende është në nivel të ulët, në shumë segmente grua nuk është e barabartë me bashkëshortin dhe ndihet dukshëm diskriminimi dhe mënjanimi i saj në të gjitha sferat e jetës. Në shumë vende ende zbatohen normat patriarkale në këtë aspekt.

1.7.2 Parimi i laicitetit

Ky parim gjen vend të rëndësishëm në rregullativën ligjore, ku kuptimi i martesës shprehet si bashkësi jetësore e bashkëshortit dhe bashkëshortes e cila është e rregulluar me

³⁰Marina Janjic -Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic:" Porodico parvo", Izdavocko preduze HHce "Homoc" d.o.o. Beograd, 1999, fq 364

³¹ Neni 9 i Kushtetutës së RMV-së

anë të ligjit. Nga përmbajtja e një formulimi të tillë rrjedh interesimi i shoqërisë së gjerë që ky institucion shoqëror të jetë i rregulluar me dispozita ligjore dhe i mbrojtur nga shoqëria dhe shteti.³² Ky formim i këtyre dispozitave ligjore nuk ka arritur të depërtojë në vetëdijën njerëzore, pikërisht sepse këto marrëdhënie martesore deri në pjesën e parë të shekullit XIX ishin të rregulluara nga e drejta e shenjtë muslimane dhe ajo e krishterë. Legjislacioni ynë njih vetëm martesën civile, të lidhur përpara organeve kompetente shtetërore. Bashkëshortët mund të lidhin edhe martesë religjioze, përpara organeve religjioze, sipas përkatësisë së tyre fetare, mirëpo këto martesa nuk sjellin asnjë pasojë apo efekt juridik. Vetëm martesa civile, e lidhur përpara organeve shtetërore prodhon efekte juridike për bashkëshortët.

1.7.3 Parimi i institucionalitetit

Një nga parimet themelore të së drejtës martesore, padyshim është edhe ky parim i quajtur parimi i institucionalitetit të martesës. Martesa është institucion shoqëror dhe gëzon mbrojtje shoqërore. Martesa dhe marrëdhëniet martesore juridike janë të rregulluara me dispozita ligjore.³³ Një mbrojtje ligjore mban vetëm martesa civile, e cila njihet që është e rregulluar juridikisht, e cila lidhet në prani të organit kompetent shtetëror. Dihet që martesa është baza themelore dhe më e rëndësishmja për krijimin e familjes, kurse vetë familja është baza e shoqërisë. Me anë të familjes ndërtohen bazat kryesore të edukimit, arsimimit, ajo e edukimit moral dhe përkujdesjes fizike e shpirtërore të fëmijëve. Ndërsa fëmijët janë e ardhmja e çdo shoqërie dhe kombi, prandaj shteti ka interes të veçantë në përkujdesin dhe edukimin e tyre.

Për këtë arsye shteti shpreh interes të veçantë për familjen dhe martesën. Pra martesa është jo vetëm institucion social dhe juridik që tashmë njihet, por edhe institucion me karakter dhe interes mjaft të madhë shoqëror.

1.7.4 Parimi i monogamisë

Parimi themelor i të drejtës martesore, padyshim është parimi i monogamisë. Me anë të këtij parimi nënkuptojmë martesën në të njëjtën kohë vetëm të një burri me një grua. Sipas këtij parimi një person nuk ka të drejtë të lidhë martesë të dytë në qoftë se më përpara nuk e

³² Hamdi Podvorica "E drejta familjare", Universiteti Iliria / Romina, Prishtine, 2006, fq.62

³³ Dr. Mira Alincic Ana Bakaric – Mihanoviq : Porodicno Pravo, (Zakonodavstvo SR Hrvatska) Zagreb, 1980, fq.18

ka përfunduar martesën e parë, gjithmonë në mënyrë e cila është e përcaktuar me ligj. Çdo person ka të drejtë të lidhë numër të pakufizuar të martesave, por gjithmonë duke i dhënë zgjidhje martesës së mëparshme, gjithmonë në mënyrë ligjore.

E kundërta e monogamisë është poligamia, që do të thotë lidhje martesore ku përfshihen më tepër bashkëshortë. Pra, poligamia është kur në një martesë janë të përfshirë një numër më i madh i pjesëmarrësve nga të dy gjinitë "bashkëshortë dhe bashkëshorte", e njohur si martesë grupore ose e bashkuar. Ka dy lloje kryesore të poliagamisë:

- Poliandria dhe
- Poligjinia.

Kuptimi i poliandrisë njihet si një formë raportesh familjare me anë të së cilës një grua krijon marrëdhënie martesore me dy ose më shumë burra në të njëjtën kohë. Poliandria është në kontrast me poligjininë, ku një burrë është i lidhur me më tepër gra.

Në gjithë vendet e zhvilluara perëndimore, monogamia është forma e vetme e lejuar dhe e rregulluar me ligj të martesës. Sipas Ligjit për Familjen të RMV-së, nuk mund të lidhë martesë personi, përderisa martesa e mëparshme nuk i ka pushuar.³⁴ Në kuptim të nenit 34, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen, martesa pushon me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulim dhe me shkurorëzim të martesës.

Lidhja e një martese të dytë, ndërkohë që nuk ka pushuar martesa e parë, përbën vepër penale të dënueshme me heqje lirie, sipas Kodit Penal të RMV-së, ku përcaktohet se: *"Personi i cili lidh martesë, megjithëse ndërkohë është i martuar, do të dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 3 vjet. Njëjtë do të dënohet dhe ai i cili lidh martesë me një person për të cilin e di se është i martuar."*³⁵

1.7.5 Parimi i jetës së vazhdueshme

Martesa është bashkësi e vazhdueshme e jetesës së burrit me gruan. Kjo do të thotë se në pikëpamje kohore martesa nuk mund të përkufizohet, veçse zgjat aq sa zgjat edhe jeta e të dy bashkëshortëve. Kur martesa bëhet për ndonjë kusht ose afat të caktuar, apo për ndonjë qëllim tjetër përveç jetesës së përbashkët, si e tillë nuk është e vlefshme aspak.

³⁴ Neni 17 i Ligjit për Familjen i RMV-së

³⁵ Neni 195 i Kodit Penal të RMV-së

Sepse martesë si akt lidhet ngushtë me vullnetin e lirë të të dy palëve, si pasojë e ndjenjave të dashurisë, respektit reciprok dhe mirëkuptimit, por shumë shpesh ndodh të hasim në keqkuptime, mosmarrëveshje, duke ardhur deri në përçarje, grindje, shumë herë edhe para ditës kur ata do të vendosin për jetën e përbashkët. Këto gjendje e vështirësojnë dhe e bëjnë të pamundshme vazhdimin e kësaj bashkëjetese, prandaj shumë shpesh vjen deri tek zgjidhja e martesës apo shkurorëzimi.

KAPITULLI II

II. PROCEDURA PËR LIDHJEN E MARTESËS

2.1 Kushtet themelore për lidhjen e martesës

Kur bëhet lidhja e martesës kërkohet mënyra e lirë dhe pëlqimi i plotë i personave të cilët bien dakord për lidhje të martesës. Për lidhjen e martesës me ligj kërkohen të respektohen disa kushte të cilat paraqesin një rëndësi të posaçme, pasi synojnë të mbrojnë interesat si të personave që lidhin martesë, të fëmijëve, ashtu edhe të shoqërisë në tërësi. Kushte të rëndësishme për lidhjen e martesës janë dallimi i gjinive të personave, mosha madhore e personave që dëshirojnë të lidhin martesë, pëlqimi dhe forma për lidhjen e martesës.

Një martesë e vlefshme mund të lidhet vetëm në kushtet e parashikuara me dispozitat ligjore. Kushtet për lidhjen e martesës ose kushtet thelbësore, siç quhen ndryshe, janë:

- *Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm,*
- *Gjinitë e kundërta*
- *Lidhja e martesës përpara organit kompetent³⁶.*

Këto kushte janë të lidhura ngushtë me kuptimin e martesës, si kontratë ndërmjet bashkëshortëve, si dhe me marrëdhëniet që do të lindin me lidhjen e martesës, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre. Në momentin e lidhjes së martesës, vullneti dhe pajtimi i bashkëshortëve është një ndër kushtet themelore për lidhjen e një martese e cila konsiderohet plotësisht e vlefshme. Megjithatë vullneti i të dy palëve sundon vetëm në momentin e lidhjes së martesës. Bashkëshortët nuk do të mund të përcaktojnë përmbajtjen e marrëveshjes martesore, e as t'i përzgjedhin detyrimet e tyre bashkëshortore. Këto janë ato masa që i përcakton ligji me anë të normave dhe atë kryesisht imperative.

³⁶ Hamdi Podvorica, "E drejta familjare", Universiteti Iliria / Romina, Prishtine, 2006, fq.72

2.1.1 Pajtimi i vullneteve të bashkëshortëve për lidhjen e martesës

Kushti kryesor për lidhje martesore dihet që është pëlqimi se kjo martesë po lidhet me vullnet të të dy palëve dhe se nuk ka asnjë pengesë ose ndalesë për këtë martesë. Forma e kontratës martesore, është e kushtëzuar nga Ligji i Familjes, në të cilën duhet të shfaqet vullneti i bashkëshortëve.

Bashkëshortët e ardhshëm duhet të shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe pa të meta për lidhjen e martesës në çastin e lidhjes së saj. Ata e deklarojnë vullnetin e tyre të lirë për lidhjen e martesës përpara ofiqarit dhe personave të tjerë që marrin pjesë në procedurën për lidhjen e martesës. Deklarimi i vullnetit mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Deklarimi i vullnetit bëhet nga të dy bashkëshortët personalisht. Vetëm në raste të rralla, për shkaqe të arsyeshme mund të lejohet lidhja e martesës në prani të vetëm njërit bashkëshort, ndërsa bashkëshorti tjetër që nuk është prezent të përfaqësohet nga përfaqësues i posaçëm. Deklaratat e vullnetit të të dy bashkëshortëve duhet të jenë të pakushtëzuara dhe të menjëhershme, pra t'i japin menjëherë njëri pas tjetrit.

Martesa e lidhur në kushtet e ekzistencës së të metave në shfaqjen e vullnetit, nën dhunë dhe lajthim, nuk konsiderohet e vlefshme dhe nuk sjell pasoja juridike.³⁷ Dhunë konsiderohet kur një person me kërcënime detyron një person tjetër të deklarojë një vullnet të caktuar. Ndërsa lajthimi është krijimi i një parafytyrimi të gabuar për ndonjë fakt ose rrethanë relevante, dhe nëse bashkëshorti që ka qenë në lajthim do të kishte pasur parafytyrim të saktë për faktet dhe rrethanat, ai/ ajo nuk do të kishte lidhur martesë.

Republika e Maqedonisë së Veriut kujdeset të mbrojë përkufizimin tradicional të martesës, me mbështetje të qartë të vlerave familjare, në mënyrë që martesa si bashkësi të jetë e mbrojtur dhe e përcaktuar qartë. Por, në majë të gjithë kësaj që u tha më lartë, mbetet në qendër vullneti i të dy palëve për ta mbajtur jetëgjatësinë e një martese të suksesshme. Pra, martesa është dhe mbetet një bashkim i një burri dhe një gruaje - me anë të së cilës tregon anën biologjike të martesës, si një bashkim i krijuar nga burri dhe gruaje, pra dy persona të seksit të kundërt për të ruajtur, pra riprodhuar racën njerëzore.

³⁷ Neni 19 i Ligjit për Familjen i RMV-së

Martesa është bashkësi formale e cila është e rregulluar me ligj. Një martesë e vlefshme mund të jetë vetëm ajo bashkësi e lidhur në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me anë të ligjit. Ndërsa çdo lloj bashkimi tjetër, në të cilin një burrë dhe një grua realizojnë të gjithë përbërësit e jetës bashkëshortore, edhe nëse në raste të caktuara prodhojnë pasoja juridike të caktuara, nuk përbën martesë, por ajo është vetëm një bashkësi jashtëmartesore ose e njohur tanimë si marrëdhënie jashtëmartesore ose marrëdhënie faktike.

2.1.2 Gjini të ndryshme

Gjinitë e ndryshme krijojnë komponentin kryesor biologjik, kulturor e civilizues për një martesë. Nëse e shohim historikun, martesa lidhet ngushtë me privilegjet e gruas dhe burrit, pra të personave me gjini të kundërt. *“Mungesa e sekseve të kundërta paraqet pengesë absolute për lidhjen e një martese. Kjo, sepse martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas dhe si e tillë është përkufizuar në shumë dispozita të LFK-së, por edhe të KF-së së Shqipërisë dhe LF-së së Maqedonisë.”*³⁸ Sa i përket lidhjes së personave me sekse të njëjta nuk është e lejuar, pasi që është në kundërshtim me qëllimet natyrore të martesës si bashkësi e vazhdueshme e dy personave me gjini të kundërta.

Gjatë evoluimit në teorinë juridike janë paraqitur shumë mendime të reja, me anë të cilave vërtetimi i biseksualitetit të një bashkëshorti nuk nënkupton anulim absolut të martesës, në rast kur organi gjenital është i ndryshëm me organin gjenital të bashkëshortit tjetër.

Në shumë vende të botës perëndimore sot ekziston një tendencë për njohjen e martesës midis personave të të njëjtës gjini, të ashtuquajturat martesa homoseksuale. Motivi kryesor i lobimit për njohjen e martesave homoseksuale është mbrojtja nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, duke qenë se e drejta për të lidhur martesë është e drejtë themelore e njeriut. Për këtë lëvizje ka shumë argumente pro dhe kundër dhe është shoqëruar nga një debat i gjerë politik, fetar dhe shoqëror. Rreth 30 vende të botës i lejojnë martesat homoseksuale, kryesisht në Evropë dhe Amerikë.

³⁸ Hamdi Podvorica “ E drejta familjare”, Universiteti Iliria / Romina, Prishtine, 2006, fq.73.

2.1.3 Forma për lidhjen e martesës

Në Maqedoninë e Veriut njihet vetëm martesë civile, ndërsa martesë e lidhur sipas zakoneve fetare nuk prodhon efekte juridike.³⁹ Një nga kushtet themelore për lidhjen e martesës është forma për lidhjen e saj, e përcaktuar me ligj. Ky kusht nënkupton që pëlqimi për lidhjen e martesës duhet të jepet përpara organit kompetent në mënyrën e parashikuar me ligj. Forma për lidhjen e martesës nënkupton plotësimin e të gjithë elementeve që parashikon ligji: pjesëmarrja e bashkëshortëve të ardhshëm, pjesëmarrja e dëshmitarëve, dhënia e pëlqimeve të partnerëve dhe procedura përpara organit kompetent, e cila duhet të zhvillohet në mënyrë të përcaktuar me ligj. Duhet të plotësohen të gjithë këta elemente në mënyrë që martesë të konsiderohet e lidhur në formën e parashikuar me ligj.⁴⁰

Aspekte të rëndësishme të lidhjes së martesës konsiderohen edhe:

1. Kompetenca për lidhje martesore
 2. Kompetenca tokësore
 3. Kompetenca funksionale ,dhe
 4. Mënyra e lidhjes së martesës.
-
1. **Kompetenca për lidhje martesore** - me këtë kompetencë nënkuptojmë rrethin e punës së organeve të autorizuara për lidhjen e martesës. Kjo çështje është e rregulluar me norma të karakterit urdhërues.
 2. **Kompetenca tokësore** - nënkupton territorin brenda të cilit ushtron funksionet organi për lidhje martesore.
 3. **Kompetenca funksionale** - me këtë kompetencë nënkuptojmë funksionet e personelit zyrtar të cilët marrin pjesë në procesin e lidhjes së martesës, në bazë të normave ligjore.
 4. **Mënyra e lidhjes së martesës** - këtu përfshihet tërësia e gjithë rregullave të cilat duhet të respektohen gjatë procesit të lidhjes së martesës. Kjo mënyrë është rregulluar me ligj.

³⁹ Neni 30 i Ligjit për Familjen

⁴⁰ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 99

2.2 Pengesat martesore

Pengesat martesore janë rrethana dhe fakte që nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Pengesat martesore janë ndalesa apo kufizime nga të cilat nuk mund të kryhet martesë në mes kategorive të lidhjeve të caktuara shoqërore. Në Ligjin për familje ku parashikohen këto pengesa martesore:

- a) *Mungesa e vullnetit*,
- b) *Martesa ekzistuese*,
- c) *Sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar*,
- d) *Gjinia*, dhe
- e) *Mituria*.⁴¹

Mungesa e vullnetit - Siç u sqarua dhe më sipër, martesë nuk do të jetë e plotfuqishme kur pajtimi për lidhjen e saj është dhënë nën ndikimin e dhunës ose lajthimit.⁴² Martesa konsiderohet se është lidhur me dhunë kur njëri bashkëshort detyron bashkëshortin tjetër të deklarojë pëlqimin për lidhjen e martesës. Ndërsa lajthimi është krijimi i ndonjë parafytyrimi të gabuar për ndonjë fakt ose rrethanë relevante që ka të bëjë me bashkëshortin tjetër.

Martesa ekzistuese - Personi nuk mund të lidhë martesë, përderisa martesë e mëparshme nuk i ka pushuar.⁴³ Martesa pushon me vdekjen e njërit bashkëshort, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulim dhe me shkurorëzim të martesës.⁴⁴ Bigamia, apo lidhja e një martesë të dytë, ndërkohë që nuk ka pushuar martesë e mëparshme, përbën edhe vepër penale, të dënueshme me heqje lirie.

Sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar - Nuk mund të lidhin martesë personat të cilët për shkak të formës së manifestuar të sëmundjes psikike në prani të simptomave psikotike

⁴¹ Hamdi Podvorica “ E drejta familjare”, Universiteti Iliria / Romnor, Prishtine, 2006, fq. 76

⁴² Neni 19 i Ligjit për Familjen

⁴³ Neni 17 i Ligjit për Familjen

⁴⁴ Neni 34, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

ose me shenja reziduale nga sëmundja nuk janë në gjendje që ta kuptojnë rëndësinë e martesës dhe obligimeve që dalin prej saj dhe janë njëkohësisht të paaftë për të gjykuar. Nuk mund të lidhin martesë edhe personat me zhvillim të metë mendor (psikik) ,nëse i takojnë grupit të personave me prapambetje të rëndë dhe më të rëndë mendore ku IQ është nën 36 shkallë. Ndërsa personat të cilët konsiderohen si persona me pengesa të lehta në zhvillimin mendor ose psikik, si edhe personat të cilët kanë sëmundje të trashëguara nga familja, mund të lidhin martesë pas mendimit të marrë lidhur me konstruksionin gjenetik të dhënë nga Enti për shëndet mendor të fëmijëve dhe të rinjve në Shkup ose ndonjë institucion përkatës që merret me hulumtime gjenetike.⁴⁵

Gjinia - Pengesë për lidhjen e martesës përbën gjinia e gjakut, por edhe ajo e adoptimit dhe krushqisë. Kështu sipas legjislacionit tonë, nuk mund të lidhin martesë ndërmjet tyre të afërmit e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë (gjyshi, gjyshja, nëna, babai dhe nipërit), si dhe as vëllezërit dhe motrat, vëllai dhe motra nga babai, gjegjësisht nga nëna, xhaxhai dhe fëmija i vëllait, daja dhe fëmija i motrës, halla dhe fëmija i vëllait, teza dhe fëmija i motrës, as kushërinjtë e parë. Nuk mund të lidhin martesë edhe personat gjinia e të cilëve është e bazuar në adoptim.⁴⁶ Nuk mund të lidhin martesë vjehri dhe nusja, dhëndri dhe vjehrra, njerku dhe thjeshtra, pa marrë parasysh nëse lidhja martesore me të cilën kanë ardhur në këtë lidhje familjare ka përfunduar.⁴⁷ Gjinia jashtëmartesore paraqet pengesë për lidhjen e martesës ashtu sikurse edhe gjinia martesore.⁴⁸

Mosha e mitur - Një person nën moshën 18 vjeç nuk mund të lidhë martesë. Gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore mund të lejojë martesën e personit që ka mbushur moshën 16 vjeç ,nëse konstaton se ai ka arritur pjekurinë fizike dhe mendore të nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave që dalin nga martesja, pasi paraprakisht është marrë mendim nga institucioni shëndetësor ndihmë profesionale nga Qendra për punë sociale.⁴⁹

⁴⁵ Neni 18 i Ligjit për Familjen

⁴⁶ Neni 20 i Ligjit për Familjen

⁴⁷ Neni 21 i Ligjit për Familjen

⁴⁸ Neni 22 i Ligjit për Familjen

⁴⁹ Neni 16 i Ligjit për Familjen

Hapi i parë që bën nënpunësi civil është verifikimi i ndonjë pengese të mundshme. Kjo thuhet qartë në nenin 24: *“Nënpunësi i gjendjes civile do të kontrollojë në bazë të deklaratës së personave që duan të martohen dhe nëse është e nevojshme edhe në mënyrë tjetër, nëse ka ndonjë pengesë ligjore për lidhjen e martesës.”*⁵⁰ Ndërsa në nenin 29 të Ligjit për Familjen thuhet ndër të tjera: *“Lidhja e martesës fillon me raportin e gjendjes civile se kërkuesit janë të pranishëm dhe se në bazë të dokumenteve, deklarimeve të bashkëshortëve të ardhshëm dhe dëshmitarëve është konstatuar se nuk ka pengesa për lidhjen e martesës.”*⁵¹

Nëqoftëse vërehet ndonjë nga pengesat e mësipërme bëhet anulimi i kësaj lidhje martesore e cila bëhet e qartë në nenin 35, ku thuhet: *“Martesa do të anulohet, nëse vërtetohet se në momentin e lidhjes së saj ka ekzistuar ndonjë nga pengesat martesore të parashikuara në nenet 16 deri në 22 të këtij ligji.”*⁵²

Pra, pengesat martesore absolute e bëjnë në mënyrë të prerë, absolute, të pavlefshme lidhjen e martesës me cilin do person. Pengesat martesore absolute janë: sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, mituria deri në moshën 16-vjeçare dhe ekzistimi i martesës. Pengesat e tilla nuk dallojnë asnjë person dhe veprojnë mbi të gjithë personat pa dallim.

2.3 Procedura për lidhjen e martesës

Procedura për lidhjen e martesës është e përcaktuar me ligj. Organi kompetent për lidhjen e martesës është organi administrativ për mbajtjen e librave amzë të të kurorëzuarve, që vepron në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë. Ligjvënësi u jep bashkëshortëve të ardhshëm lirinë të zgjedhin sipas vullnetit të tyre vendin e lidhjes së martesës. Kështu, në nenin 15 të Ligjit për Familjen thuhet: *“Martesën mund ta lidhin dy persona të gjinive të ndryshme me vullnet të deklaruar lirisht para organit kompetent, në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*⁵³ Organi kompetent është çdo organ administrativ për mbajtjen e librave amzë të të kurorëzuarve në gjithë territorin e vendit.

⁵⁰ ZAKOH 3A CEMEJCTBOTO (LIGJI PËR FAMILJE)

https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osemejstvo_osnoven.pdf

⁵¹ ZAKOH 3A CEMEJCTBOTO (LIGJI PËR FAMILJE)

https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osemejstvo_osnoven.pdf

⁵² Po aty.

⁵³ Neni 23 i Ligjit për Familjen

2.3.1. Procedura paraprake

Procedura paraprake përfshin veprimet të cilat ndërmerren përpara vetë lidhjes së martesës, pra janë veprime që i paraprijnë lidhjes së martesës. Këto veprime ndërmerren me qëllim që të vërtetohet synimi i bashkëshortëve të ardhshëm për të lidhur martesë, si dhe për të vërtetuar se nuk ekzistojnë pengesa martesore. Fillimisht, personat që kanë për qëllim të lidhin martesë duhet të dorëzojnë një fletë-paraqitje në organin kompetent për mbajtjen e librave amzë të të kurorëzuarve. Fletë-paraqitjen mund ta japin me shkrim ose me gojë në procesverbal. Sëbashku me fletë-paraqitjen, bashkëshortët e ardhshëm janë të detyruar të dorëzojnë dhe çertifikata nga librat amzë të të lindurve. Përveç këtyre dokumentave, nëse është e nevojshme, dorëzohen dhe dokumenta të tjerë. Në rastin kur ekziston ndonjë pengesë martesore që mund të hiqet, nevojitet aktvendim me të cilin lejohet lidhja e martesës. Kur njëri nga bashkëshortët e ardhshëm ka pasur një martesë të mëparshme është e nevojshme të dorëzohet dhe vendimi për shkurorezimin apo anulimin e martesës. Ndërsa, në rastin kur njëri nga bashkëshortët do të lidhë martesë nëpërmjet personit të autorizuar, nevojitet të dorëzohet edhe autorizimi i posaçëm (prokura).⁵⁴

Në procedurën paraprake, nënpunësi i gjendjes civile ka detyrimin të verifikojë nëse ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë për ekzistencën e pengesave martesore mes bashkëshortëve të ardhshëm. Këtë gjë ai e bën kryesisht nëpërmjet dëgjimit të deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm dhe sipas nevojës edhe me mënyra të tjera. Nëse nënpunësi i gjendjes civile vërteton se ekzistojnë pengesa martesore që e pamundësojnë lidhjen e martesës, ai është i detyruar me aktvendim ta refuzojë lidhjen e martesës. Kundër këtij aktvendimi, personat e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimin të aktvendimit të lëshuar nga ana e nënpunësit të gjendjes civile. Në bazë të ankesës vendos personi i cili udhëheq organin administrativ për mbajtjen e librave amzë të të kurorëzuarve.⁵⁵ Nëse nënpunësi vërteton se parashtruesit e fletë-paraqitjes i përmbushin të gjitha kushtet e parashikuara me ligj, si dhe

⁵⁴ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 108-109

⁵⁵ Neni 24 i Ligjit për Familjen

vërteton se nuk ekzistojnë pengesa martesore, në marrëveshje me personat që duan të lidhin martesë cakton ditën dhe orën e lidhjes së martesës.

2.3.2 Lidhja e martesës përpara organit kompetent

Lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne dhe në hapësirë zyrtare të veçantë, të përcaktuar për këtë. Shumë herë personat që e bëjnë kërkesën e lidhjes së martesës duan që këtë procedurë ta bëjnë jashtë ambientit zyrtar të administratës, dhe sipas nenit 26, kjo procedurë është e mundur, por shpenzimet për gjithë këtë procedurë bien mbi kërkuesin. Kështu, me kërkesën e personave që dëshirojnë të lidhin martesë, martesë mund të lidhet jashtë ambienteve zyrtare të administratës për mbajtjen e librave amzë, me miratimin e drejtorit të administratës. Në rastet kur martesë lidhet jashtë ambienteve zyrtare të administratës për mbajtjen e regjistrave, të gjitha shpenzimet për lidhjen e martesës i bart kërkuesi. Përjashtimisht, personat që dëshirojnë të martohen jashtë ambienteve zyrtare të administratës për mbajtjen e regjistrave, mund të përjashtohen nga pagesa, me miratimin e drejtorit të administratës, nëse ka arsye të justifikuara për këtë. Për mënyrën dhe shumën e shpenzimeve për lidhjen e martesës jashtë ambienteve zyrtare, aktin nënligjor do ta përcaktojë Ministri i Punës dhe Politikës Sociale brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Familjen.⁵⁶

Gjatë procedurës të gjithë duan që në këtë ditë të kenë njerëz të afërt në një moment të tillë të rëndësishëm të jetës së tyre, por sipas ligjit të pranishëm në këtë ceremoni janë personat e përcaktuar në nenin 27:” *Martesa lidhet në prani të personave që dëshirojnë të lidhin martesë, anëtarit të këshillit të komunës që do ta caktojë, anëtarit të këshillit të komunës, dy dëshmitarëve dhe ofiqarit. Dëshmitar në lidhjen e martesës mund të jetë çdo person me zotësi veprimi.*”⁵⁷

Në raste posaçërisht të arsyeshme, organi kompetent për mbajtjen e librave amzë të të martuarve mundet me aktvendim që martesë të lidhet në prani të vetëm njërit nga

⁵⁶ Neni 26 i Ligjit për Familjen

⁵⁷ Neni 27 i Ligjit për Familjen

bashkëshortët e ardhshëm dhe personit të autorizuar të bashkëshortit tjetër. Fletë-autorizimi përmban të dhëna personale për dhënësin e autorizimit, autorizuesit dhe personit me të cilin dhënësi i autorizimit dëshiron të lidhë martesë.⁵⁸

Në nenin 29 sqarohet procedura e ceremonisë martesore. Lidhja e martesës fillon me raportin e nënpunësit të gjendjes civile se kërkuesit janë të pranishëm dhe se në bazë të dokumenteve, deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm dhe dëshmitarëve është konstatuar se nuk ka pengesa për lidhjen e martesës. Nëse martesë lidhet me prokurë, lexohet prokura e lëshuar. Pasi anëtari i këshillit konstaton se nuk ka kundërshtim për raportin e nënpunësit të gjendjes civile, ai i njëj bashkëshortët e ardhshëm me rëndësinë e martesës dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj. Më pas ai pyet secilin nga bashkëshortët e ardhshëm individualisht nëse pranojnë të lidhin martesë me bashkëshortin e ardhshëm.

Nënpunësi i gjendjes civile do të regjistrojë deklaratën e bashkëshortëve të ardhshëm se janë dakord për lidhjen e martesës në librin amzë të të martuarve, i cili më pas nënshkruhet nga bashkëshortët e ardhshëm, anëtari i këshillit komunal, dëshmitarët dhe nënpunësi i gjendjes civile. Martesë lidhet kur bashkëshortët e ardhshëm nënshkruajnë në librin amzë të të kurorëzuarve. Pas nënshkrimit të dy bashkëshortëve të ardhshëm, anëtari i këshillit komunal do të deklarojë se martesë është lidhur mes gruas dhe burrit, të theksuar me emrat e tyre. Menjëherë pas regjistrimit në librin amzë të të kurorëzuarve, bashkëshortëve do t'u lëshohet një çertifikatë nga libri amzë i të kurorëzuarve.⁵⁹

⁵⁸ Neni 28 i Ligjit për Familjen

⁵⁹ Neni 29 i Ligjit për Familjen

KAPITULLI III

III. PASOJAT PERSONALE JO PASURORE TË LIDHJES SË MARTESËS

3.1 Përcaktimi i mbiemrit të bashkëshortëve

Pasojat juridike të lidhjes së martesës manifestohen dhe në mbiemrin e bashkëshortëve. Sipas nenit 31 të Ligjit për Familjen, *“Në momentin e lidhjes së martesës, bashkëshortët mund të bien dakord që të marrin mbiemrin e njërit ose tjetrit bashkëshort ose secili prej tyre të mbajë mbiemrin e tij ose secili prej tyre t’i shtojë mbiemrit të tij mbiemrin e bashkëshortit tjetër ose njëri prej bashkëshortëve të marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër dhe atij mbiemri t’i shtojë mbiemrin e tij.”* Pra mbiemri gjithmonë përcaktohet me marrëveshje të të dy palëve. Në pamje të parë duket normë e logjikshme dhe moderne. Shpesh, ka nga ata që do të donin të mbanin dy mbiemra. Për shembull, gruaja e porsamartuar dëshiron të mbajë mbiemrin e vajzërisë dhe të shtojë mbiemrin e bashkëshortit. Legjislacioni ynë e lejon këtë mundësi.

Rregullimi i pasojës që ka të bëjë me përcaktimin e mbiemrit të bashkëshortëve, në gjendje të qetë, me mirëkuptimin e plotë që në momentin e lidhjes së martesës, nuk i lë hapësirë asnjërit bashkëshort të përdorë shantazhin e mbiemrit në zgjedhjen e martesës.

Kur martohen, bashkëshortët deklarojnë se cili do të jetë mbiemri i tyre në të ardhmen, kështu që bashkëshortët zgjedhin mbiemrin me vullnetin e tyre të lirë dhe në bazë të ligjit. Siç e shohim, sipas legjislacionit tonë bashkëshortët kanë 4 mundësi për zgjedhjen e mbiemrit, gjë që është në përputhje me parimin e barazisë midis burrave dhe grave. Çështja e zgjedhjes së mbiemrit është e përcaktuar me normë juridike alternative, ku bashkëshortët kanë mundësi të zgjedhin njërin nga këto opsione:

- 1) të marrin mbiemrin e njërit ose tjetrit bashkëshort ,
- 2) secili bashkëshort të mbajë mbiemrin e tij ,
- 3) secili bashkëshort mbiemrit të tij t’i shtojë dhe mbiemrin e bashkëshortit tjetër ,dhe

4) njëri bashkëshort ta marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër dhe atij mbiemri t'i shtojë mbiemrin e tij.

Në praktikë, më së shpeshti është gruaja ajo që merr mbiemrin e bashkëshortit ose mbiemrit të saj i shton mbiemrin e bashkëshortit. Janë të rralla rastet kur burri merr mbiemrin e gruas ose kur mbiemrit të tij ia shton edhe mbiemrin e gruas.

E drejta krahasuese gjithashtu përcakton ekzistencën e disa mendimeve lidhur me këtë çështje. Sipas një mendimi, gruaja merr mbiemrin e burrit me vetë aktin e martesës. Sipas një mendimi të dytë, me lidhjen e martesës, burri dhe gruaja kanë mundësi të mbajnë mbiemrin e tyre, nëse nuk shprehin dëshirën për të ndryshuar mbiemrin. Ndërsa, sipas një tjetër mendimi, secili bashkëshort, edhe burri, edhe gruaja, për hirë të parimit të barazisë, mund t'i shtojnë mbiemrit të tyre, mbiemrin e bashkëshortit tjetër.

3.2 Zgjedhja e punës dhe profesionit

Sipas nenit 32 të Ligjit për Familjen: "*Secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit.*" Kjo normë ka karakter imperativ, gjë që e përjashton mundësinë që njëri bashkëshort të ndikojë në zgjedhjen e punës dhe profesionit të bashkëshortit tjetër. Ligjvënësi nuk lejon marrëveshje të bashkëshortëve, me anë të së cilës, njërit prej tyre, zakonisht gruas, do t'i kufizohet ose hiqet liria e zgjedhjes së punës dhe profesionit.

Në fakt, zgjedhja e punës dhe profesionit të bashkëshortëve është një nga të drejtat themelore të njeriut, që shpreh parimin e barazisë dhe emancipimit të gruas në shoqëri. Kjo e drejtë ka një rëndësi të madhe në pavarësinë personale ekonomike të secilit bashkëshort dhe për këtë arsye është pjesë përbërëse e gjithë legjislacioneve moderne familjare.

Puna si një nga nocionet që e përbëjnë objektin e së drejtës së punës, ka të bëjë me punën si përdorim i fuqisë punëtore. E megjithatë nuk është punë çdo përdorim i fuqisë punëtore nga ana e njeriut, por vetëm përdorim i vetëdijshëm dhe me qëllim të caktuar më parë i fuqisë punëtore, gjë që është veti vetëm e njerut.⁶⁰ Çdonjëri nga partnerët është i lirë të zgjedhë punën dhe profesionin që dëshirojnë të ushtrojë. Kjo pavarësi për zgjedhje ka të bëjë

⁶⁰ Gëzime Starova, E drejta e punës, Logos A, Shkup, 2004, f.20

me të drejtën e secilit, madje ndonjëherë edhe pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Në ambientet patriarkale, gratë ishin të vendosura në një gjendje të nënshtruar. Asokohe keqkuptimet në këtë çështje mund të çonin në prishje të marrëdhënieve martesore e cila mund të sillte edhe divorcin.

Por megjithatë në çdo rast, ligjvënësi nuk lejon heqjen e lirisë së zgjedhjes së punës dhe profesionit, që jepet me ligj. Kjo liri që tashmë e gëzojnë të dy palët ka sjellë mirëkuptim dhe bashkëpunim më të madh tek çiftet bashkëshortore, duke qenë në të shumtën e rasteve përkrahës dhe motivues të njëri-tjetrit për të ecur përpara. Parimi i të drejtës së punës, që ngërthen në vetëvete edhe të drejtën e punësimit, është një nga parimet themelore dhe më të rëndësishme të marrëdhënieve të punës.⁶¹ Çdokush ka të drejtë të punojë çfarë të dojë dhe ka liri të plotë në zgjedhjen e profesionit. Ajo që mbetet është edhe mbështetja reale, faktike nga partneri.

3.3 Zgjedhja e vendbanimit të përbashkët të bashkëshortëve

Edhe vendbanimi përcaktohet çdo herë nga bashkëshortët me marrëveshje. Por kur ka rrethana të caktuara si puna në një qytet tjetër, shkollimi i mëtutejshëm, specializimi, qëndrimi studimor e të tjera, është e mundur që bashkëshortët të ndahen, pra të ndahen në mënyrë hapësinore për një kohë më të gjatë ose më të shkurtër, në varësi të kohës së duhur për të kryer misionin e caktuar. Por më e rëndësishmja është që mes tyre të ketë marrëveshje, pra të mos ketë negativitet mes tyre dhe të mos çojë në shtrëngim nga ana e njërit bashkëshort kur zgjedh vendbanimin, sepse nëse kjo çon në detyrim, mund të prishen marrëdhëniet martesore dhe kjo mund të çojë në divorc.⁶² Në dispozitat ligjore nuk ka caktim të detyrueshëm të vendbanimit të bashkëshortëve. Pra ata janë mëse të lirë të zgjedhin hapësirën ku do të qëndrojnë në mënyrë të lirë dhe të pavarur.

⁶¹ Fatmire Lumani, E drejta e punës, Tetov, 2011, f.109

⁶² Љиљана Спиrowиќ – Трпеновска Семејно право НИП „Студентски збор“ – Скопје 2004 година, 77.

3.4 Jetesa e përbashkët e bashkëshortëve

Jeta e përbashkët dhe vendbanimi i përbashkët asnjëherë nuk duhet ngatërruar, sepse jetesa e përbashkët nënkupton një kategori më të gjërë se sa vetë vendbanimi i përbashkët. Për këtë jetesë të përbashkët atyre u lejohet të vendosin me anë të një marrëveshjeje. Pra, drejtimi apo orientimi i një familjeje të përbashkët nga njëra anë nënkupton sigurimin e gjërave të nevojshme për sigurimin e jetesës dhe mbarëvajtjen e familjes, si dhe nga ana tjetër plotësimin e të gjitha nevojave aktuale të familjes, si organizimi i sigurimit të ushqimit për familjen, pagesa e faturave për mirëmbajtje të banesës, mbajtja e higjienës në ambientet e përbashkëta familjare, si dhe shumë detyrime tjera që dalin rrugës gjatë jetës së përbashkët.

Procesi i menaxhimit të familjes duhet të jetë shumë miqësor nga bashkëshortët (pra të dy palët), pasi që çdo mosmarrëveshje e mundur mund të sjellë divorc. Bashkëjetesa e cila njihet si jetesë e përbashkët në çift kur partnerët sillen, si bashkëshortë ka karakter të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, pra që nënkupton jetesën e përbashkët dhe mbi të gjitha interesat të përbashkëta, siç janë: ndihma morale e materiale në mes të personave që bashkëjetojnë dhe fëmijëve që lindin nga kjo bashkëjetesë. Personat që vendosin të bashkëjetojnë nuk kanë dhe as nuk ushtrojnë cilësinë ligjore të bashkëshortëve as në lidhje me të drejtat dhe detyrimet reciproke e as atyre kundrejt të tretëve.

Cilësinë e bashkëjetuesve mund ta kenë edhe ata persona të cilët mund të jenë të lidhur në martesë sipas ceremonisë fetare, por pa lidhur martesë sipas formës së parashikuar nga Ligji për Familjen. Të njëjtin status mund ta kenë edhe dy persona martesë e të cilëve është shpallur e pavlefshme, me përjashtim të efekteve që sjell martesë e pavlefshme kur njëri nga bashkëshortët nuk e ka ditur shkakun e pavlefshmerisë së martesës.

3.5 Kontributi në plotësimin e nevojave të familjes

Fakt është se marrëdhëniet e shëndosha familjare, vlerat familjare, si dhe funksioni korrektues socializues i një familjeje, kanë një kontribut të madh në rritjen dhe zhvillimin kulturor dhe social të një vendi dhe një shoqërie. Të dy bashkëshortët me organizimin e ekonomisë familjare bashkarisht kujdesen për sigurimin e mjeteve për nevojat e familjes në përgjithësi. Megjithatë, për të gjitha detyrimet në lidhje me jetën e përbashkët të

bashkëshortëve, ata duhet të kujdesen edhe për mbështetjen e fëmijëve që vijnë si pasojë e jetës së përbashkët. Të dy bashkëshortët janë bashkarisht përgjegjës në masë të njejtë për të gjitha nevojat e familjes. Sipas të drejtave martesore patriarkale të cilat bazohen në parimin e përgjegjësisë ekskluzive të burrit për nevojat e vazhdueshme të familjes, gruaja thuhet se ishte e përjashtuar nga kontributi real material në plotësimin e nevojave të familjes. Ajo angazhohej vetëm në punët e amvisërisë dhe mbajtjen e përkujdesin ndaj fëmijëve.

Në të drejtën krahasuese sot vihen re dhe legjislacione sipas të cilave kontributi i gruas në familje thotë se ajo ekziston në bazë të përgjegjësisë subsidiare të gruas. Ndërsa sa i përket Ligjit për familje të RMV-së, ai parashikon që bashkëshortët, secili gjithmonë sipas aftësive të tyre, duhet të kujdesen sëbashku për të plotësuar nevojat e familjes.⁶³

Regjimi pasuror martesor me ligj në RMV, përbëhet nga një kombinim i regjimit të pronësisë së përbashkët dhe regjimit të pronësisë së veçantë të bashkëshortëve. Në pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve përfshihet pronësia mbi sendet e luajtshme (të holla, mobilje, mjete motorike, etj.) dhe të paluajtshme (toka, ndërtesa, etj.), të cilat janë fituar gjatë kohëzgjatjes së jetës së përbashkët bashkëshortore dhe shërbejnë për plotësimin e nevojave të bashkëshortëve dhe jetës familjare. Bashkësia martesore është njëherazi dhe një lloj bashkësie ekonomike, në të cilën bashkëshortët nëpërmjet ekonomizimit të përbashkët plotësojnë interesat e tyre jetësore. Për plotësimin e nevojave të tyre dhe të fëmijëve bashkëshortët përdorin sende të ndryshme të luajtshme e të paluajtshme. Në një martesë funksionale e harmonike nuk shtrohet problemi i përkatësisë së këtyre sendeve, mbi të cilat bashkëshortët ushtrojnë të drejtën e pronësisë së përbashkët në mënyrë të heshtur. Sendet e tilla që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve dhe të familjes janë: banesa familjare, mobiljet, pajisjet elektroshtëpiake, makina etj. Këto sende janë në pronësi të përbashkët të bashkëshortëve, të cilët i administrojnë dhe disponojnë bashkarisht dhe me marrëveshje. Bashkëshortët mund të bëjnë ndarjen e këtyre sendeve, si gjatë kohëzgjatjes së martesës, ashtu

⁶³ Neni 33 i Ligjit për Familjen.

dhe pas pushimit të saj. Ndarja mund të bëhet me marrëveshje, pa pasur nevojë për ndërhyrjen e gjykatës, në rrugë gjyqësore ose me marrëveshje të arritur nga ana e palëve përpara gjykatës.

3.6 Detyrimi për besnikëri bashkëshortore

Kur flasim për detyrimet reciproke që lidhen me besnikërinë bashkëshortore nuk është vetëm një detyrim moral dhe shoqëror, por në të shumtën e rasteve edhe detyrim ligjor i bashkëshortëve, e cila nënkupton shmangien ose ndalimin e marrëdhënieve afektive dhe seksuale të bashkëshortëve jashtë martesë dhe ka për qëllim të mbajë gjallë lidhjen afektive dhe shpirtërore midis tyre. Megjithatë në RMV detyrimi për besnikëri bashkëshortore rrjedh nga parimi i monogamisë mbi të cilin bazohet instituti i martesës.

Ligji për Martesën i vitit 1973 dhe spektri i efekteve personale të martesës të parashikuara është më i gjerë e cila përveç detyrimeve të sipërpërmendura përfshin dhe: detyrimin për besnikëri ,si dhe detyrimin për ndihmë reciproke (neni 24). Në rradhë të dytë, këto të drejta dhe detyrime paraqesin më tepër formën e një modeli të jetës bashkëshortore. Në rradhë të tretë, mospërbushja e këtyre detyrimeve nuk i jep jetë veprimeve ligjore të drejtpërdrejta për mospërbushje të detyrimeve, siç ndodh me detyrimet kontraktore, por çon në çrregullim të marrëdhënieve bashkëshortore deri sa bëhen të padurueshme, gjë që, sipas LF, përbën shkak për të kërkuar zgjidhjen e martesës. Si dhe në rradhë të katërt, përbushja e të drejtave dhe detyrimeve me karakter personal, jopasuror nuk realizohet nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit, por në mënyrë vullnetare nga vetë bashkëshortët, në funksion të respektimit të jetës së tyre private.

Kurse në RMV detyrimi për besnikëri bashkëshortore është ajo që rrjedh nga parimi i monogamisë mbi të cilin bazohet instituti i martesës. Janë premtimet ato që kanë fuqi lidhëse vetëm ,nëse bazuar tek arsyja janë të mundshme për zbatim nga ana e personit që bën premtimin. Kur flasim për martesën ajo mbi çdo gjë është një premtim i mundshëm ,nëse bashkëshortët premtojnë se do të bëjnë maksimumin që ajo të funksionojë, por në pothuajse

gjysmën e rasteve, kur kemi parasysh statistikat e divorceve, premtimi për angazhim të përjetshëm rezulton i pamundur për t'u mbajtur.⁶⁴

3.7 Detyrimi për ndihmë morale

Kur flasim për martesën, duhet të kemi parasysh se përpara se të shëndrrohet në institucion juridik, martesë ka qenë institucion social. Madje që nga fillimi i njerëzimit, bashkimi i gruas dhe i burrit në martesë ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë dhe krejt në fillim, rregullimi i martesës ka qenë çështje morali. Nga kjo, morali i një shoqërie formësohet nga idetë mbi mënyrën e drejtë dhe të gabuar të jetesës, që kanë anëtarët e një shoqërie të caktuar. Pra, asnjë institucion tjetër juridik, nuk është kaq ngushtë i lidhur me moralin, madje mendohet se *“martesa është krijim i moralitetit.”*⁶⁵ Megjithatë, sipas teorisë që e percepton martesën si kontratë, kushtet dhe detyrimet morale të martesës konceptohen si premtime të ndërsjellta që bashkëshortët i japin njëri-tjetrit në momentin e lidhjes së martesës. Përmbajtja e tyre varet nga praktikat sociale dhe ligjore e zakonisht janë premtime që kanë të bëjnë me ekskluzivitetin e marrëdhënieve intime dhe përjetësinë e lidhjes martesore, por natyra premtuese nënkupton se bashkëshortët si palë kontraktore mund t'i negociojnë kushtet dhe ta lirojnë njëri-tjetrin nga detyrimet martesore.

Tradhëtia bashkëshortore konceptohet gjerësisht ,si moralisht e gabuar sepse përbën shkelje të premtimit martesor që bashkëshortët i kanë bërë njëri-tjetrit për ekskluzivitet në marrëdhëniet midis tyre. Por, nëse detyrimet bashkëshortore janë thjesht premtime që bashkëshortët i bëjnë njëri-tjetrit, atëherë palët mund ta lirojnë njëri-tjetrin nga detyrimi për ekskluzivitet, duke i bërë të lejueshme marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore. Dihet që martesë është gurrthemeli i të gjitha marrëdhënieve bashkëshortore, të cilat pa dyshim janë të kushtëzuara nga natyra dhe qëllimi i martesës.

⁶⁴ Albana Metaj-Stojanova, Regjimet pasurore martesore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin shqiptar, Tiranë, 2019, fq. 22-23 marrë nga: <https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2019/07/Albana-Metaj-Stojanova.pdf>

⁶⁵ Po aty, fq. 10

Prandaj, pikërisht për shkak të shumëllojshmërisë së nuancave apo llojeve të marrëdhënieve martesore ato janë të lidhura me moralin, seksualitetin, ndjenjat, por jo vetëm.

3.8 Të drejta dhe detyrime të parashikuara në akte të tjera normative

Gjatë momentit të lidhjes së martesës për bashkëshortët automatikisht lindin të drejta dhe detyrime me karakter personal dhe pasuror. Madje, për shkak të karakterit institucional të martesës, të drejtat dhe detyrimet rrjedhin *ex lege* nga momenti i lidhjes së martesës, pa qenë e nevojshme që palët t'i parashikojnë ato shprehimisht. Ndërsa sa i përket të drejtave dhe detyrimeve personale të bashkëshortëve, legjislacioni aktual i përmend në mënyrë deklarative, pa bërë një elaborim të detajuar të tyre. Megjithatë, të drejtat dhe detyrimet personale konsiderohen: themelimi i bashkësisë jetësore, barazia e bashkëshortëve, respekti i ndërsjelltë dhe ndihma reciproke. Përveç këtyre, të drejta dhe detyrime personale të bashkëshortëve të rregulluar nga Ligji për Familjen i RMV-së, mbi të cilat shtrihet efekti i martesës janë dhe: e drejta për ndryshimin ose mbajtjen e mbiemrit, pavarësia në zgjedhjen e punës dhe profesionit, si dhe vendosja me marrëveshje për vendin e jetës së përbashkët.⁶⁶

Kur flasim për normat ligjore mbi të drejtat dhe detyrimet personale të bashkëshortëve ato ishin shumë të rëndësishme në aspekt të përcaktimit të fajit në rast divorci, sot, në epokën e divorcit pa faj, rregullat ligjore mbi marrëdhëniet personale të bashkëshortëve, shpesh janë vetëm një përfaqësim simbolik i asaj që duhet të jetë ideali i jetës bashkëshortore. Madje, ideja që ligji mund të bind ,si dhe të urdhërojë qëndron pikërisht në bazë të rregullimit ligjor të marrëdhënieve personale brenda familjes.

Ndërsa, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve ekzistojnë gjithmonë brenda periudhës kohore nga momenti i lidhjes së martesës ,si dhe deri në pushimin e saj, megjithatë në fakt bashkëshortët shpesh nuk i ushtrojnë të drejtat apo nuk i përmbushin detyrimet, pasi bashkësia e tyre jetësore ka përfunduar, megjithëse martesa formalisht vazhdon të ekzistojë. Nga këndvështrimi tjetër, me termin “bashkësi martesore”, nënkuptojmë ekzistencën e elementeve themelore të martesës me anë të të cilave realizohen qëllimet e saj, apo e thënë ndryshe ekzistenca e bashkësisë martesore ka nënkuptim dhe përmbushjen e nevojave

⁶⁶ Nenet 31-33 të Ligjit për Familjen.

komplekse e të gërshetuara të bashkëshortëve dhe zhvillimin e marrëdhënieve bashkëshortore, siç janë: ato psikologjike, marrëdhëniet biologjike, ekonomike, emocionale, etj.

Kur flasim për banesën familjare ai është vendi në të cilin bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre familjare, por dhe vendi në të cilin zhvillohen lidhjet emocionale afektive midis anëtarëve të familjes. Rëndësia e saj është e jashtëzakonshme sa i përket jetës dhe ekzistencës së përditshme të anëtarëve të familjes. Pa ekzistencën e banesës familjare nuk mund të mendohet përmbushja e funksioneve shoqërore të familjes. Për këtë arsye, dekadat e fundit, legjislacionet evropiane kanë njohur rëndësinë e banesës familjare, duke i siguruar asaj status dhe mbrojtje të veçantë ligjore, gjë që reflektohet në të drejta pronësie të kufizuara të bashkëshortëve dhe në një mbrojtje më të madhe të interesave të fëmijëve, veçanërisht të nevojshme në raste të zgjidhjes së martesës.⁶⁷

3.8.1 Fitimi i zotësisë për të vepruar si rezultat i martesës

Kur flasim për zotësinë për të vepruar duhet thënë se është një cilësi shumë e rëndësishme e subjektivitetit të personit fizik sepse nëpërmjet saj shfaqet personaliteti i tij në qarkullimin juridik. Zotësia për të vepruar është zotësia e personit që me veprimet e tij, të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Ekzistenca e zotësisë juridike merr formën e saj të plotë kur personat arrijnë moshën madhore, pra kur mbushin 18 vjeç. Zotësia për të vepruar, ashtu sikurse zotësia juridike është një cilësi, një veçori shoqërore juridike dhe jo një e drejtë subjektive. Nëpërmjet zotësisë për të vepruar, pra me anë të shprehjes së vullnetit juridikisht relevant të personave fizik, del në pah një nga parimet kryesore të së drejtës civile, që është parimi i iniciativës së lirë apo i autonomisë së vullnetit. Vlefshmëria e vullnetit të shprehur të personit fizik lidhet ngusht me arritjen e moshës së caktuar dhe pjekurinë mendore, sepse vetëm mbi këto baza personi mund të marrë pjesë në marrëdhënie juridike civile, të shpalosë vullnetin e tij, i cili ka të bëjë me shprehjen e interesave të tij të njohura me ligj.

⁶⁷ Albana Metaj-Stojanova, A Comparative View on the Legal Protection of Family Home and the Current Situation in RM. In *Proceedings of the 11-th Annual South-East European Doctoral Student Conference: Infusing Research and Knowledge in South-East Europe*, pp. 109-119. South-East European Research Centre, Thessaloniki, Greece, 5 / 2017, marrë nga: <https://www.seerc.org/yrw/2017/files/DSC2017-Proceedings.pdf>

Sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut zotësia për të vepruar fitohet në moshën 18 vjeç. Me këtë nënkuptojmë se në të drejtën tonë procesi i gjatë i pjekurisë së personit fizik arrin pikën e maturisë me mbushjen e moshës 18 vjeç, pra në momentin kur përfundon moshja e mitur dhe fillon moshja madhore e njohur ,si +18 vjeç. Me anë të kësaj del në pah ndërgjegjja e personit për veprimet e ndërmarra në qarkullimin juridik dhe pasojat e këtyre veprimeve, të cilat duhet të jenë në interes të tij dhe njëkohësisht në përputhje me ligjin.⁶⁸

Të miturit nga moshja 14 vjeç, respektivisht 15 apo 16 vjeç e deri në 18 vjeç kanë zotësi të pjesëshme veprimi sepse mund të shprehin vullnet juridikisht të vlefshëm vetëm në këto raste:

- 1) për pranimin e dhuratës ,
- 2) për përpilimin e testamentit (zotësia testamentare) ,
- 3) për themelimin e marrëdhënies së punës ,dhe

4) mund të shprehin vullnet të vlefshëm në bazë të martesës së lidhur përpara moshës madhore (nëpërmjet institutit të emancipimit), vetëm pas mbushjes së moshës 16 vjeç.

Legjislacioni maqedonas i konsideron të mitur të gjithë fëmijët deri në arritjen e moshës madhore, pra nuk bën dallim midis të miturve më të vegjël dhe më të mëdhenj në moshë. Kushti i dytë për fitimin e zotësisë për të vepruar është shëndeti psikik apo mendor i personit fizik që ka mbushur moshën 18 vjeç. Nëse personi i moshës madhore nuk është i shëndoshë mendërisht, ai do të jetë nën mbikëqyrjen e përfaqësuesit ligjor (prindit ose kujdestarit), i cili në emër dhe për llogari të tij do të shprehë vullnet juridikisht të vlefshëm.

Emancipimi është institut në bazë të të cilit i lejohet martesa të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç. Të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç mund t'i lejohet të lidhë martesë, nëse gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore vërteton se ka arritur pjekurinë trupore dhe mendore që nevojitet për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, me mendim paraprak nga institucioni shëndetësor dhe ndihmë eksperte nga Qendra

⁶⁸ Abdulla Aliu, E drejta civile, Prishtinë, 2013, fq. 240-243

për punë sociale.⁶⁹ Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut dhe që kërkon detyrimisht një pjekuri fizike dhe intelektuale (psikike) të mjaftueshme për të marrë përsipër detyra, të drejta dhe përgjegjësi, jo vetëm dhe thjesht emocionalisht, por në thelb, realisht.⁷⁰ Dhënia e lejes për lidhjen e martesës bëhet në procedurë të veçantë jashtëkontestimore, në të cilën gjykata lejon lidhjen e martesës nga i mituri i moshës 16 deri në 18 vjeç, kur ekzistojnë rrethana që e justifikojnë lidhjen e martesës. Në këtë procedurë, propozimin për dhënien e lejes për lidhjen e martesës e parashtron i mituri, ndërsa në rastin kur të dy personat që duan të lidhin martesë janë të mitur, ata parashtrojnë propozim të përbashkët. Në aktvendimin me të cilin të miturit i lejohet lidhja e martesës, deklarohet personi me të cilin i lejohet të lidhë martesë dhe se martesa mund të lidhet vetëm pas plotfuqishmërisë së vendimit. Megjithëse aktvendimi ka karakter konstitutiv sepse shërben si bazë për lidhjen e martesës, i mituri do të fitojë zotësinë e plotë për të vepruar vetëm nëse martesa lidhet, dhe vetëm nëse lidhet me personin e deklaruar në aktvendim. Kur vërtetohet se një person ka arritur pjekurinë trupore dhe mendore për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga lidhja e martesës, është e justifikuar që ta fitojë zotësinë e veprimit me lidhjen e martesës, para moshës 18 vjeç.⁷¹ Kjo do të thotë se zotësia e veprimit e fituar në këtë mënyrë, nëpërmjet emancipimit nuk do të humbasë edhe nëse martesa ndërpritet, pra i mituri do të vazhdojë të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

3.8.2 Fitimi i shtetësisë si rezultat i martesës

Kemi parasysh që shtetësia është lidhje juridike midis një njeriu dhe një shteti, lidhje e cila e bën të mundur që mbi personin të ushtrohet veprimi i ligjeve të atij shteti. Ansambleja e OKB-së ka miratuar konventën mbi shtetësinë e vajzave të martuara, me anë të së cilit bëhet një hap mjaft i rëndësishëm i cili lidhet me zëvendësimin e parimeve tradicionale. Prandaj, *“secili shtet kontraktues pajtohet se as lidhja e as zgjidhja e martesës ndërmjet një shtetasi të tij dhe të huajit, e as ndryshimi i shtetësisë nga bashkëshorti gjatë martesës nuk do të ndikojnë*

⁶⁹ Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen dhe Neni 98 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁷⁰ Albana Metaj-Stojanova “Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile” në “Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetovë, 2022, fq. 171-172

⁷¹ Nenet 93-105 të Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore të RMV-së

*automatiksht në shtetësinë e gruas.*⁷² Si rrjedhojë e kësaj gruaja ka të drejtën e shtetësisë pa imponim të bashkëshortit. *“Nga vetë dëshira e bashkëshortëve do të varej nëse ata e ndryshojnë shtetësinë.”*⁷³ Megjithatë, sipas gjithë kësaj gruaja mund ta mbajë edhe mëtutje shtetësinë që kishte para se të lidhte martesë, ose të marrë shtetësinë e burrit ,por gjithmonë me dëshirën e saj dhe pa u shtyrë nga tjetri. Shteti, gruas i garanton të drejta të barabarta me të burrit, edhe kur bëhet fjalë për fëmijët. *Fëmija do të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe do të ketë që nga lindja të drejtën në emër, të drejtën e fitimit të shtetësisë dhe sa është e mundur, të drejtën që t’i njohë edhe të jetë nën kujdesjen e prindërve të tij apo asaj.*⁷⁴ Pra, edhe fëmija i ka të gjitha të drejtat e tij sapo të vjen në jetë, dhe sipas legjislacionit tonë e fiton shtetësinë qoftë nga nëna, qoftë nga babai, pa asnjë diskriminim gjinor. Ndërkohë ekzistojnë ende vende në botë, ku shtetësia e fëmijëve mund të fitohet vetëm nga babai, por jo edhe nga nëna.

⁷² Ineta Ziemele dhe Gunnar G. Schram: Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, INDNJ, Oslo, Norvegji, fq.316.

⁷³ Marina Janjic -Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic:“ Porodicno parvo”, Izdavocko preduzeHHce “Homoc” d.o.o. Beograd, 1999, fq 119

⁷⁴ Ineta Ziemele dhe Gunnar G. Schram: Deklarata universale mbi te drejtat e njeriut, INDNJ, Oslo, Norvegji, fq.317

KAPITULLI IV

IV. PASOJAT PASURORE TË LIDHJES SË MARTESËS

4.1 Marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve

Në të kaluarën rregullimi i marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve në trojet shqiptare është bërë për një kohë shumë të gjatë nga e drejta zakonore shqiptare.

E drejta zakonore shqiptare është tërësia e normave apo rregullave të pashkruara të sjelljes, të vendosura *ad hoc* nga gjykatat e pleqve apo kuvendet për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në fusha të ndryshme të jetës, zbatimi i të cilave sigurohej nga forca e traditës, opinionit shoqëror dhe nga autoriteti patriarkal i organizmave të vetqeverisjes së popullit. Ajo është krijuar nga populli gjatë shekujve dhe jo nga një person i caktuar apo organ legjislativ i posaçëm. E drejta zakonore shqiptare njihte pronësinë private mbi sende të luajtshme e të paluajtshme, të tilla si toka, shtëpi, kullota, bagëti, kafshë e mjete pune.⁷⁵

Ngritja në kult e superioritetit të burrave ishte thelbësor për zhvillimin e kësaj tradite nënshtrimi. Kanuni e konceptonte gruan si një qenie të dobët, për këtë arsye e konsideronte si inferiore dhe i caktonte asaj detyra dytësore në raport me burrin. Bashkëshortët në martesë ishin të pabarabartë, jo vetëm në aspekt të pozitës juridiko-pasurore të tyre, por dhe në aspekt të pozitës juridiko-personale. Kjo pabarazi shprehet qartë në përkufizimin që i bën martesës Kanuni i Lekë Dukagjinit sipas të cilit: *“m’u martue me kanun do’ me thanë m’u ba shpi, me i a shtue shpis nji rob ma tepër, sa për krah të punve, sa për të shtuem të fmive.”*⁷⁶

Gjatë krijimit të familjes së vogël, e cila është e ashtuquajtur familje sipas kurorës, bashkëshortët sillnin dhe krijonin të mira materiale për plotësimin e nevojave të tyre dhe të fëmijëve të tyre. Për shkak të dominimit të pronësisë së përbashkët familjare, sfera e pronësisë personale ishte shumë e ngushtë e si rrjedhojë dhe instituti i trashëgimisë ishte i pazhvilluar. Kështu nëse vdiste ndonjë anëtar i familjes nuk çelej trashëgimia e pasuria nuk ndahej sepse

⁷⁵ Neni 213-266 i Kanunit të Lekë Dukagjinit; Neni 357-411 i Kanunit të Labërisë; Neni 1192, 1205 i Kanunit të Lumës.

⁷⁶ Neni 28 i Kanunit të Lekë Dukagjinit.

edhe trashëgimlënësi edhe trashëgimtarët ishin pjesëtarë të një familjeje të madhe e pasuria do të vazhdonte të ishte në pronësi të familjes.

Sipas kanunit ai e përjashtonte mundësinë e ekzistencës së pronësisë së veçantë të bashkëshortëve.

Për shkak të specifikave apo veçantive historike të zhvillimit të shtetit dhe legjislacionit maqedonas, e drejta e RMV-së është ndarë në dy periudha më kryesore:

Periudha e parë - ku bëjnë pjesë zhvillimet deri në vitin 1946, periudhë në të cilën Maqedonia e Veriut asokohe ende nuk ishte formuar si shtet i pavarur ,dhe

Periudha e dytë - zhvillimet pas vitit 1946 kur krijohet RPM si pjesë përbërëse e RFPJ.

E drejta e Jugosllavisë së vjetër ka mbrojtur qëndrimin se e gjithë pasuria, që bashkëshortët fitonin gjatë jetës bashkëshortore i takonte burrit, nëse nuk mund të argumentohej e kundërta. Pothuajse në gjithë territorin e ish Jugosllavisë zbatoheshin ngjashëm regjimi ligjor i pasurisë së ndarë të bashkëshortëve. Sipas këtij regjimi, gjithë pasuria që bashkëshortët sillnin në martesë, si dhe pasuria e krijuar gjatë kohëzgjatjes së martesës, konsiderohej si pasuri e veçantë e secilit prej tyre. Kjo pasuri administrohej dhe disponohej në mënyrë të pavarur nga secili bashkëshort, nëse me kontratë nuk ishin marrë vesh ndryshe.⁷⁷

Megjithatë, regjimi i bashkësisë së përgjithshme pasurore të bashkëshortëve nuk ishte parashikuar nga ligji dhe mund të vendosej vetëm me kontratë nga ana e bashkëshortëve. Megjithëse regjimi ligjor ishte ai i pasurisë së ndarë, bashkëshortët shpesh vendosnin të krijonin bashkësi pasurore duke bashkuar në një tërësi të vetme pjesë të caktuara ose gjithë pasuritë e tyre të veçanta. Si rregull administrimi dhe disponimi me këtë pasuri kryhej nga bashkëshorti. Ndërsa, bashkëshortët shprehimisht me kontratë mund të merreshin vesh që administrimi dhe disponimi me pasurinë të mos ishte e drejtë ekskluzive e bashkëshortit.

⁷⁷ Neni 771, 772 i Kodit Civil të Mbretërisë Serbe (1844).

4.1.1 Regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

Nga momenti i lidhjes së martesës, për bashkëshortët krijohet automatikisht regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët të tyre. Pasuria që bashkëshortët do të fitojnë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore përbën pasuri të përbashkët të tyre.⁷⁸ Duke pasur parasysh këtë, mund të themi se që të ekzistojë pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, është e nevojshme ekzistenca e bashkësisë martesore, si dhe pasuria duhet të fitohet gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore.

Dihet që pasuria e përbashkët e bashkëshortëve njëherit paraqet një institut specifik me karakter të veçantë juridiko-pasuror, në kuadër të së drejtës familjare. Kur flasim për natyrën e saj dihet që është specifike e cila përjashton mundësinë që ajo të konsiderohet thjesht si pronësi në kuptimin e së drejtës civile. Në fakt pronësia e përbashkët e bashkëshortëve është rezultat i të gjitha marrëdhënieve, jo vetëm të atyre pasurore, por edhe atyre personale ndërmjet bashkëshortëve, e cila dallon nga pronësia civile e cila rregullohet me norma imperative të njohura edhe si urdhëruese. Natyra specifike, mjaft e veçantë e kësaj pasurie buron nga fakti se të dy bashkëshortët janë titullarë të së drejtës së pronësisë, mirëpo vlera e pjesëve të tyre nga pasuria e përbashkët kryesisht nuk dihet. Megjithatë, deri në pjesëtimin e kësaj pasurie, bashkëshortët martesorë janë titullarë të të gjitha të drejtave në pjesët e papërcaktuara të sendeve e të të drejtave dhe bartës të detyrimeve me shumica të papërcaktuara të kërkesave. Pikërisht, ky mospërcaktim i vlerës së pjesëve të bashkëshortëve si titullarë të së drejtës së pasurisë së përbashkët, as në mënyrë ideale e as në mënyrë reale është tjetër karakteristikë, e cila e dallon pasurinë e përbashkët nga llojet e tjera të pronësisë (si psh. bashkëpronësia).⁷⁹

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dallon dukshëm nga të gjitha të drejtat e tjera pasurore, tek të cilat si subjekte të së drejtës paraqiten më tepër persona, pra dukshëm kemi të bëjmë me subjekt grupor. Bartës të së drejtës së pronësisë në pjesë të pacaktuara të sendeve në pronësi të përbashkët të bashkëshortëve paraqiten të dy bashkëshortët si subjekt i dyfishtë.

⁷⁸ Neni 67 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore i RMV-së

⁷⁹ Marina Janjic -Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: " Porodicno parvo", Izdavocko preduzeHHce "Homoc" d.o.o. Beograd, 1999, fq 364

Ndër karakteristikat kryesore të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve është, se të gjitha objektet e pronësisë, qofshin edhe ato sende të luajtshme ose të paluajtshme, u takojnë bashkëshortëve sëbashku. Këto pjesë nuk janë të ndara as realisht, as idealisht, kështu që e drejta e tyre e pronësisë shtrihet mbi gjithçka që është krijuar me punë gjatë kohëzgjatjes së jetës së përbashkët martesore.

Duke pasur parasysh sa u theksua më sipër, pronësia e përbashkët e bashkëshortëve i nënshtrohet një regjimi të veçantë deri në momentin e ndarjes së saj. Pikërisht për të mbrojtur këtë regjim të veçantë, ligjvënësi ka krijuar disa mekanizma. Kështu, ligji përcakton shprehimisht se e drejta e pronësisë së bashkëshortëve mbi pasuritë e paluajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e tyre të përbashkët, do të regjistrohet në librat publikë në emër të të dy bashkëshortëve. (Neni 69, parag.1 i LPDTS) Edhe nëse e drejta e pronësisë mbi paluajtshmëritë e përbashkëta është regjistruar vetëm në emër të njërit bashkëshort, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dyve. (Neni 69, parag.2 i LPDTS). Regjimi i pasurisë së përbashkët apo bashkësisë ligjore, që për herë të parë u prezantua nga Kodi Civil Francez i vitit 1804.⁸⁰

Nëse krahasojmë regjimin e pasurisë së përbashkët me regjimin e pasurive të ndara të bashkëshortëve mund të themi se të dy regjimet, përveç anëve pozitive, kanë edhe mangësi të tyre. Regjimi i pasurive të ndara nuk është i drejtë sidomos nga perspektiva e grave shtëpiake, që i janë përkushtuar rritjes së fëmijëve dhe nuk kanë të ardhura apo pasuri të vetat, të cilat mund të mos përfitojnë asnjë pasuri në rast divorci, pavarësisht viteve të përkushtimit për mbarëvajtjen e familjes, rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Ndërsa regjimi i pasurisë së përbashkët nga ana tjetër, ka defektin që ndarja e pasurisë në rast divorci, shpesh kërkon shitjen dhe ndarjen e asetit të vetëm të rëndësishëm të familjes, që është banesa familjare, gjë që do të shkaktonte vështirësi për fëmijët dhe bashkëshortin të cilit i besohen ata pas divorcit. Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve, e cila është krijuar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore.⁸¹ Regjimi i pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve është vendosur si regjim i detyrueshëm para se gjithash në frymën e parimit të barazisë midis bashkëshortëve. Sikurse të

⁸⁰ 147 Neni 1399-1400, Titulli 5, Kapitulli 2 i KC Francez (1804).

⁸¹ 148 Neni 67 i LPDTS.

gjitha legjislacionet moderne, ligji nuk bën dallim midis pozitës juridike të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë apo faktikë kur bëhet fjalë për të drejtat pronësore të tyre.

Kështu, bashkëshortët mund të punojnë bashkërisht punë të të njëjtit profesion (psh. të dy bashkëshortët janë bujq, tregtarë etj.) ose të ushtrojnë profesione të ndryshme. Kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pronësisë së përbashkët mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë.

Bazuar në teorinë juridike dhe praktikën shumëvjeçare të gjykatave në zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve, duke filluar nga Ligji Themelor për Martesën (1946), për të vazhduar me Ligjin për Martesën të RSM-së (1973) dhe Ligjin për Familjen të RM-së (1992), i mbështetur nga LPDTS (2001) mund të identifikojmë objektin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, të përbërë nga:

1) sendet e luajtshme e të paluajtshme të fituara gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore ,

2) të ardhurat e fituara nga sendet në pronësi të përbashkët ,

3) të hollat e kursyera në bashkësinë martesore ,

4) sendet e blera nga të ardhurat e fituara nga shitja e sendeve në pronësi të përbashkët ose sendet e shkëmbyera me sendet në pronësi të përbashkët ,

5) kompensimet për sendet që janë marrë ose shkatërruar nga pronësia e përbashkët ,

6) sendet që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të bashkëshortëve ,

7) sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve ,

8) sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave personale të njërit prej bashkëshortëve, dhe

9) sendet e fituara nga bashkëshortët jashtëmartesorë, të cilët më vonë kanë lidhur martesë.

4.1.2 Puna si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

Puna si kusht për krijimin e pasurisë së përbashkët, nënkupton faktin se kjo pasuri mund të krijohet vetëm me punë gjatë ekzistimit të martesës.⁸² Dihet që puna e bashkëshortëve konsiderohet si kushti i parë për krijimin e pronësisë së përbashkët, qoftë ajo punë e përbashkët në bujqësi, zeytari apo tregti, qoftë puna e ushtruar veçmas nga bashkëshortët në veprimtari apo profesione të ndryshme. Megjithatë, kontributi për krijimin e pasurisë së përbashkët mund të jetë i drejtpërdrejtë, nga të ardhurat nga puna, ose i tërthortë, kur puna e njërit bashkëshort mundësohet nga ndihma e tjetrit, që nuk punon jashtë familjes, por përkujdeset për amvisërinë dhe rritjen e fëmijëve. Kur flasim për kontributin e bashkëshortit në fitimin e pronësisë së përbashkët nuk varet vetëm nga përfitimet e drejtpërdrejta financiare, por edhe nga puna shtëpiake në familje ,si dhe kujdesi për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Pra për këtë rast, paditësja prej momentit të lidhjes së martesës është kujdesur për jetën familjare duke kryer gjithë punët shtëpiake dhe ato të lidhura me rritjen e fëmijëve ,si dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për mbarëvajtjen e jetës familjare. Puna, si kusht për krijimin e pronësisë së përbashkët, përmendet shprehimisht në legjislacionet familjare të të gjitha vendeve të ish Jugosllavisë me të cilat Maqedonia e Veriut ka një traditë të përbashkët juridike.⁸³

E megjithatë, puna si një nga bazat kryesore për krijimin e pasurisë së përbashkët, siç u përmend, merret parasysh nga praktika gjyqësore në Maqedoninë e Veriut në të gjitha llojet e saj, qoftë ajo punë me efekt të drejtpërdrejtë financiar, qoftë ajo punë që kontribuon në ruajtjen e këtij fitimi.

4.1.3 Sendet që shërbëjnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve

Kur flasim për sendet e përbashkëta të luajtshme, veprimet juridike të secilit bashkëshort duhet kuptuar që janë të vlefshme edhe kur janë kryer pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, por për tjetërsimin e pasurive të përbashkëta të paluajtshme nevojitet pëlqimi i të dy bashkëshortëve. Pra, e gjithë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, e cila është fituar nga

⁸² Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, 2007 fq.102

⁸³ Ligji për Familjen i Serbisë, Neni 171, "Sluzbeni Glasnik RS" br.18/2005; Ligji për Familjen i Kroacisë, Neni 36, "Narodne Novine RH", br.103/2015; Ligji për Familjen i Kosovës, Neni 47, "Gazeta Zyrtare" nr.4/2006.

bashkëshortët, qoftë sëbashku apo veçmas gjatë martesës, por me përjashtim të pasurisë vetjake hyn menjëherë, sapo fitohet në bashkësi dhe konsiderohet ,si pasuri e bashkësisë. Çfarë nënkuptojmë me termin “pasuri e fituar”. Me termin “pasuri e fituar” gjatë martesës duhet të kemi parasysh jo vetëm sendet e luajtshme e të paluajtshme, të fituara me titull pronësie apo një të drejte tjetër reale, por mbi të gjitha edhe të drejtat e kreditit dhe paditë që mbrojnë këto të drejta, si dhe të mirat jomateriale. Pikërisht, bashkëshortët gjatë martesës mund të fitojnë çdo send apo të drejtë që gjendet në qarkullimin juridikocivil. Kur flasim për momentin e fitimit të sendeve të përbashkëta, ai duhet të jetë pas datës së lidhjes së martesës. Pra, si datë e fitimit konsiderohet ajo datë kur njëri nga bashkëshortët bëhet titullar i së drejtës së pronësisë ose një të drejte reale tjetër. Në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, nuk shohim ndonjë ndryshim thelbësor sa i përket rregullimit ligjor të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pas shkëputjes së vendit nga ish Jugosllavia dhe shpalljes së pavarësisë. E nga ana tjetër legjislacioni shqiptar pësoi ndryshim tërësisht pas rënies së regjimit komunist, e cila tashmë ofron zgjidhje për situatat e reja të krijuara me njohjen e pronës private dhe zhvillimin e iniciativës së lirë dhe ekonomisë së tregut.

Por për plotësimin e nevojave të tyre dhe të fëmijëve bashkëshortët përdorin sende të ndryshme të luajtshme e të paluajtshme. Kur flasim për një martesë funksionale si dhe harmonike nuk shtrohet problemi i përkatësisë së këtyre sendeve, mbi të cilat bashkëshortët e ushtrojnë të drejtën e pronësisë së përbashkët në mënyrë të heshtur.

Këto sende shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të bashkëshortëve dhe të familjes janë: banesa familjare, mobiljet, pajisjet elektroshtëpiake, makina etj. Këto sende janë në pronësi të përbashkët të bashkëshortëve, të cilët i administrojnë por edhe i disponojnë bashkarisht dhe me marrëveshje. Bashkëshortët kanë të drejtë të bëjnë ndarjen e këtyre sendeve si gjatë kohëzgjatjes së martesës, ashtu dhe pas pushimit të saj. Kjo ndarje mund të bëhet me marrëveshje, pa pasur nevojë për ndonjë ndërhyrje të gjykatës, në rrugë gjyqësore ose me marrëveshje të arritur nga ana e palëve përpara gjykatës.

Në pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve përjashtimisht mund të bëjnë pjesë dhe sendet që janë krijuar me punë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore e që shërbejnë për

plotësimin e nevojave personale të njërit prej tyre, të tilla si: garderoba personale, aksesorë, libra, koleksione të ndryshme, makina etj. ligjvënësi në RMV, përgjithësisht këto sende i klasifikon si pronësi të veçantë të bashkëshortëve, por lejon mundësinë, që kriteri i përdorimit të tyre ekskluzivisht nga njëri bashkëshort, të mos i përjashtojë këto sende nga pronësia e përbashkët.

4.1.4 Administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët

Administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët varet nga regjimi ligjor i pasurisë. Me termin administrim të pronësisë së përbashkët nënkuptohet tërësia e veprimeve faktike dhe juridike, si dhe masave të ndryshme që ndërmerren me qëllim të ruajtjes së sendit dhe shfrytëzimit normal ekonomik të tij. Administrimi përfshin punët që kanë të bëjnë me: riparimin, ruajtjen dhe mbajtjen e sendeve të përbashkëta, punimin e rregullt të tokës, pagimin e shpenzimeve të domosdoshme lidhur me sendet nga pronësia e përbashkët, dhënien me qira, mbledhjen e frutave natyrore dhe shitjen e tyre, mbledhjen e frutave civile, si dhe ndërmarrjen e të gjitha masave që kanë të bëjnë me posedimin dhe shfrytëzimin e drejtë të këtyre të mirave.

Me disponim të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nënkuptohet ndërmarrja e atyre veprimeve juridike, për të cilat nevojiten autorizimet më të larta që mund të ketë personi mbi sendin. Autorizimi i disponimit me sendin, nënkupton tjetërsimin ose ngarkimin me barrë të sendeve nga pronësia e përbashkët, si nëpërmjet punëve juridike (siç janë shitja, dhënia e sendit me qira, dhurimi, shkëmbimi, lënia peng apo vendosja e hipotekës, krijimi i servitutit etj.), ashtu edhe nëpërmjet disponimit faktik me këto sende (psh. shembja e ndërtesës së përbashkët për të ndërtuar një të re).

Në ndryshim nga administrimi i sendit të përbashkët, disponimi është vetëm i herëpashershëm dhe jo i vazhdueshëm, por megjithatë duke qenë se disponimi nënkupton autorizimet më të larta pronësore mbi sendin, aktet e disponimit kanë pasoja juridike më të rëndësishme, pra rëndësi më të madhe në praktikë sesa aktet e administrimit. Veprimet juridike të administrimit karakterizohen nga ruajtja e substancës së pasurisë, duke u kufizuar në vjeljen e frutave natyrorë apo civilë, ndërkohë që tek veprimet e disponimit veçori dalluese

është ndryshimi i substancës së pasurisë, ndryshim ky që vlerësohet duke u bazuar në kritere ekonomike apo juridike. Bashkëshortët si titullarë të pronësisë së përbashkët janë të autorizuar, që bashkarisht dhe me marrëveshje të administrojnë dhe disponojnë me sendet në pronësi të përbashkët.⁸⁴

Këto të drejta të bashkëshortëve lidhur me administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët janë pasojë e natyrës juridike të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, mënyrës së fitimit të saj dhe parimit të barazisë dhe solidaritetit të bashkëshortëve. 116 Bashkëshortët me kontratë rregullojnë mënyrën dhe masën e administrimit dhe disponimit me sendet në pronësi të përbashkët, por duhet pasur parasysh se këto kontrata nuk janë përfundimtare e të pandryshueshme, përkundrazi, bashkëshortët varësisht nga rrethanat, kanë mundësi që në çdo kohë të kontraktojnë diçka tjetër.⁸⁵

Për të shmangur mosmarrëveshjet dhe kontestet eventuale në këtë sferë të ndjeshme të marrëdhënieve bashkëshortore, ligji ka përcaktuar kufijtë e autorizimit të bashkëshortit, i cili e administron pronësinë e përbashkët. Për këtë arsye, ligjvënësi përdor termat: “administrim i rregullt”, “disponim në kuadër të administrimit të rregullt” dhe “disponim i jashtëzakonshëm”. Me administrim të rregullt të sendit nënkuptohet ndërmarrja e veprimeve faktike dhe atyre juridike lidhur me sendet që përbëjnë pronësi të përbashkët të bashkëshortëve si p.sh. riparimi dhe mirëmbajtja e sendit të përbashkët, punimi i rregullt i tokës, mbledhja e frutave, pagimi i shpenzimeve të nevojshme të ndriçimit, ngrohjes, pagimi i detyrimeve, taksave, tatimeve, marrja e qirasë etj. Kur bëhet fjalë për ndërmarrjen e punëve që paraqesin administrim të rregullt të sendeve në pronësi të përbashkët (siç është punimi i tokës), ato mund t’i kryejë edhe vetëm njëri nga bashkëshortët. Në këtë rast vlen supozimi ligjor se ekziston pëlqimi i bashkëshortit tjetër.⁸⁶

Me disponim të sendit brenda administrimit të rregullt nënkuptohet se bashkëshorti që administron pronësinë e përbashkët ka edhe të drejtën që të tjetërsojë sendet e konsumueshme, frutat dhe sendet aksesore, por nuk ka të drejtë të tjetërsojë sendin kryesor.

⁸⁴ Neni 70, paragrafi 1 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

⁸⁵ Neni 71, paragrafi 4 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

⁸⁶ Neni 71, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

Nëse bashkëshortët nuk kanë kontraktuar diçka tjetër, administrimi i sendit do të përfshijë edhe disponimin brenda kufijve të administrimit të rregullt.⁸⁷

Në ndërmarrjen e punëve që paraqesin disponim të sendit brenda administrimit të rregullt, si p.sh. tjetërsimi i sendeve të konsumueshme, frutave e sendeve aksesore, bashkëshorti duhet të sigurojë dhe pëlqimin e bashkëshortit tjetër, të dhënë në çfarëdo lloji forme, me shkrim, me gojë ose heshtje. Disponimi i jashtëzakonshëm me pronësinë e përbashkët apo ndërmarrja e punëve që i kalojnë kufijtë e administrimit të rregullt, nënkupton ndërmarrjen e punëve juridike me të cilat tjetërsohen ose ngarkohen sendet kryesore që përbëjnë pronësinë e përbashkët, siç janë p.sh. shitja e sendit, dhurimi, shkëmbimi, dhënia me qira e sendit, ndryshimi i destinacionit të sendit, krijimi i të drejtës së pengut mbi sendet e luajtshme me vlerë, apo vendosja e hipotekës, servitutit apo barrës sendore mbi sendet e paluajtshme kryesore që përbëjnë pronësi të përbashkët të bashkëshortëve.⁸⁸

Në rast të ndërmarrjes së punëve që paraqesin disponim të jashtëzakonshëm me pronësinë e përbashkët, pra që i kalojnë kufijtë e administrimit të rregullt, siç janë shitja, dhurimi, shkëmbimi i sendit të paluajtshëm, vendosja e hipotekës etj., bashkëshorti duhet të sigurojë pëlqimin e bashkëshortit tjetër, të shprehur në formën, e cila kërkohet për punën juridike përkatëse që do të lidhet.⁸⁹

Pra, me pronësinë e përbashkët nuk mund të disponojë vetëm njëri nga bashkëshortët, pa pasur pëlqimin e shprehur në formë të përshtatshme të bashkëshortit tjetër. Pamundësia, që me pronësinë e përbashkët të disponojë vetëm njëri nga bashkëshortët, është pasojë e natyrës juridike të pasurisë së përbashkët. Meqenëse pjesët e bashkëshortëve nuk janë të ndara as realisht, e as idealisht, rezulton se asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të disponojë në mënyrë të pavarur me pronësinë e përbashkët, e as me pjesën e vet ideale në të. Në praktikë, duke pasur parasysh se marrëdhëniet martesore, si parim duhet të zhvillohen në harmoni të dyanshme, me administrim dhe disponim me marrëveshje të pronësisë së përbashkët, shpesh në praktikë nënkuptohet lejimi i heshtur nga ana e njërit bashkëshort, që bashkëshorti tjetër të

⁸⁷ Neni 71, paragrafi 2 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

⁸⁸ Neni 37, paragrafi 1 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

⁸⁹ Neni 72 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

kryejë punët për të cilat ai është më i aftë. Prandaj, është normale që dhe në marrëdhëniet me personat e tretë, të paraqitet po ky bashkëshort gjatë administrimit dhe disponimit me pasurinë e përbashkët. Megjithatë, edhe pse gjatë gjithë kohëzgjatjes së martesës, vetëm njëri bashkëshort është paraqitur në marrëdhënie me personat e tretë, kjo në asnjë rast nuk do të thotë se sendet që përbëjnë objektin e punëve juridike të lidhura prej tij, nuk bëjnë pjesë në pronësinë e përbashkët.⁹⁰

Nga natyra juridike e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve rezulton se bashkëshortët nuk kanë të drejtë që të disponojnë me sendin në pronësi të përbashkët, por kanë vetëm të drejtën e shfrytëzimit të përbashkët të sendit. Sendet që përbëjnë pronësinë e përbashkët shfrytëzohen nga bashkëshortët me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre dhe të familjes. Shfrytëzim i sendit, do të thotë shfrytëzim i vetive ekonomike të sendit, pra i përfitimeve të drejtpërdrejta që mund të japë sendi. Si bartës të përbashkët të së drejtës së pronësisë mbi këto sende bashkëshortët i shfrytëzojnë ato bashkarisht e me marrëveshje. Në të drejtën e RMV nuk ekzistojnë dispozita juridike me të cilat do të zgjidhej kontesti që do të krijohej nga shfrytëzimi i përbashkët i sendit nga ana e bashkëshortëve.⁹¹

Me aktet e administrimit dhe disponimit me sendet në pronësi të përbashkët bashkëshortët realizojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre pasurore në martesë. Ligji ka parashikuar mundësinë, që bashkëshortët me kontratë me shkrim të merren vesh për aktet e administrimit dhe disponimit me sendet në pronësi të përbashkët, megjithatë, mundësinë e keqpërdorimit të të drejtave që rrjedhin nga kontrata, ligjvënësi e ka rregulluar me anë të nenit 71/4 të LPDTS, sipas së cilit: *“secili nga bashkëshortët ka të drejtë që në çdo kohë të shkëpusë kontratën për administrim dhe disponim me sendet nga pronësia e përbashkët, për sa kohë konsideron se me administrimin dhe disponimin e tillë i është shkaktuar dëm.”*

⁹⁰ Albana Metaj-Stojanova, Administration and Disposal of the Joint Property of Spouses in the Republic of Macedonia. In *Proceedings of the XVth Jubilee International Scientific Conference "Knowledge in Practice", Bansko, Bulgaria, pp. 683-690*. Institute of Knowledge Management, Skopje, Macedonia, 12 / 2017.

⁹¹ Neni 70, paragrafi 1 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore; Neni 195 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

4.1.5 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve

Me pasuri të veçantë të bashkëshortëve nënkuptojmë pasurinë që secili bashkëshort ka pasur në momentin e lidhjes së martesës. Megjithatë, pasuria e veçantë e bashkëshortëve është gjithë pasuria e secilit prej tyre, e cila nuk përfshihet në regjimin juridik të pasurisë së përbashkët. Kështu, kur flasim për pasurinë e veçantë aty bëjnë pjesë si pasuri të fituara përpara lidhjes së martesës, ashtu dhe pasuri të fituara gjatë kohëzgjatjes së martesës, nga ku përjashtohen pasuritë e fituara me punë gjatë bashkësisë martesore. Të gjitha sendet dhe të drejtat që mund të jenë objekt i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, mund të përbëjnë dhe objekt të pasurisë së veçantë të tyre, nëse janë fituar përpara lidhjes së martesës ose gjatë kohëzgjatjes së saj, por jo në bazë të punës së bashkëshortëve.

Si pasuri e veçantë konsiderohen dhe pronësia dhe të drejtat pronësore që bashkëshorti do t'i fitojë në bazë të trashëgimisë, legatit apo dhuratës, si dhe sendet e fituara gjatë martesës, të cilat shërbejnë ekskluzivisht për nevojat personale të njërit bashkëshort, nëse ato nuk kanë një vlerë tepër të lartë në krahasim me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët.⁹²

Nëse bazohemi në teorinë juridike dhe atë praktike gjyqësore në zbatimin e dispozitave të cilat kanë të bëjnë me pronësinë e veçantë të bashkëshortëve, mundemi dukshëm të identifikojmë saktësisht objektin e pasurisë së veçantë të bashkëshortëve, që përbëhet nga:

- 1) pasuritë e fituara nga secili bashkëshort para lidhjes së martesës ,
- 2) pasuritë e fituara gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore në bazë të trashëgimisë, legut ose dhuratës ,
- 3) pasuritë që shërbejnë për plotësimin e nevojave personale të njërit bashkëshort, kur nuk janë në shpërpjesëtim me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët ,
- 4) pasuritë e fituara me ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë kohëzgjatjes së martesës,
- 5) frutat e sendeve në pronësi të njërit bashkëshort ,

⁹² Neni 68, paragrafi 2 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

- 6) pasuritë e fituara sipas bazave të ndryshme që paraqesin mirënjohje të veçantë ,dhe
- 7) veprat dhe të drejtat e autorit.

Kur jemi te detyrimet e përbashkëta apo solidare të bashkëshortëve, kreditori nuk është i detyruar të ndjekë ndonjë radhë të përcaktuar për plotësimin e kërkesës së vet nga pasuria e veçantë e njërit apo tjetrit bashkëshort ose nga pasuria e tyre e përbashkët. Prandaj mund të themi se bëhet fjalë për detyrime personale të bashkëshortit, për të cilat ai përgjigjet, përveçse me pasurinë e tij të veçantë, por edhe me pjesën e tij nga pronësia e përbashkët, në rastet kur pasuria e veçantë nuk mjafton për të përmbushur detyrimet. Detyrimet solidare të bashkëshortëve, megjithëse mund edhe të jenë marrë përsipër nga njëri bashkëshortë, mund të fshihen nga pasuria e tyre e veçantë. Megjithatë, ka mundësi që të fitohen gjatë kohëzgjatjes së martesës. Pasuri e veçantë e bashkëshortëve mund të konsiderohen edhe: - çmimet ose shpërblimet për arritje të ndryshme artistike, apo aftësi shpirtërore ose fizike, si dhe shpërblimet për sportet amatore; - çmimet dhe mirënjohjet e tjera materiale për trimërinë dhe meritat e treguara në luftë; - bursat e dhëna për studime ose kualifikim të mëtejshëm arsimor.

Në bashkësinë aktuale gjatë martesës hyn edhe pasuria e fituar nga bashkëshortët, pavarësisht asaj nëse kjo pasuri është fituar nga të dy sëbashku ose individualisht. Mjaftë e rëndësishme është ajo që fituesi i pasurisë t'a gëzojë cilësinë e bashkëshortit, ndërsa pasuria të jetë fituar pas lidhjes së martesës dhe të mos klasifikohet apo të bëjë pjesë si pasuri vetjake nga ligjvënësi. Dihet që bashkëshortët të dy sëbashku apo individualisht ata fitojnë pasuri nga burime të ndryshme ligjore gjatë martesës.

4.1.6 Sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave personale të njërit prej bashkëshortëve

Kur flasim për pronësinë e përbashkët të bashkëshortëve përjashtim mund të bëjnë pjesë dhe sendet që janë krijuar me punë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore e të cilat shërbejnë si plotësim i nevojave personale të njërit prej tyre, të tilla janë: garderoba personale, aksesore, libra, koleksione të ndryshme, makina etj. Ligjvënësi në RMV, në përgjithësi këto sende i klasifikon si pronësi të veçantë të bashkëshortëve, por edhe lejon mundësinë, që kriteri i përdorimit të këtyre ekskluzivisht nga njëri bashkëshort, të mos i përjashtojë këto sende nga pronësia e përbashkët. Nga ajo që u tha më sipër, përfshirja e sendeve të tilla në pasurinë e

përbashkët, varet jo vetëm nga vlera e sendit për të cilën bëhet fjalë, por dhe nga situata ekonomike e familjes. Megjithatë, nëse një makinë përdoret vetëm nga njëri bashkëshort, ajo do të mbetet pasuri e veçantë e tij edhe pas ndarjes, gjithmonë nëse situata ekonomike e familjes e lejon një gjë të tillë. Ndërsa, nëse situata ekonomike është e tillë, që një makinë konsiderohet si investim i rëndësishëm nga pronësi e përbashkët, në atë rast makina do të përfshihet në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve.

Gjatë kohës sa zgjat bashkësia martesore pronësi e veçantë mund të fitohet në bazë të punëve juridike pa shpërblim, siç janë: trashëgimia, legu, dhuratat, lojërat e fatit e shumë të tjera. Gjithashtu, në pronësinë e veçantë të bashkëshortit bën pjesë dhe gjithçka e fituar gjatë jetës bashkëshortore nga vënia në qarkullim e sendeve në pronësi të veçantë të tij.

4.1.7 Administrimi dhe disponimi me pasurinë e veçantë

Në të kaluarën ekzistonin kufizime të diktuar nga botëkuptimi patriarkal i kohës, për sa i përket administrimit dhe disponimit të lirë e të pavarur të bashkëshortes me pasurinë e saj të veçantë. Megjithatë, sipas Kodit Civil të Mbretërisë Serbe, sendet e luajtshme, të cilat gruaja i sillte në martesë për t'u shfrytëzuar për nevojat e saj ose të bashkëshortit, gjatë kohëzgjatjes së martesës ishin në pronësi të veçantë të bashkëshortes, por ajo nuk mund të dispononte lirisht me to pa lejen e bashkëshortit.⁹³ Asokohe, bashkëshortët e administronin dhe dispononin në mënyrë të lirë e të pavarur pasurinë e tyre vetjake dhe kishin të drejta të barabarta mbi pasurinë e përbashkët të vënë gjatë martesës. Kur flasim mbi këtë ligj, regjimi pasuror i bashkëshortëve i përcaktuar është regjimi ligjor, i cili nuk kishte të drejtë të ndryshohej në bazë të vullnetit të bashkëshortëve.

Sipas legjislacionit aktual të RMV-së, të dy bashkëshortët me kontratë mund të merren vesh, vetëm lidhur me mënyrën e administrimit dhe disponimit të pronësisë së përbashkët dhe të veçantë, të përcaktuar me këtë ligj. Pra, në RMV dukshëm mbizotëron regjimi pasuror ligjor, ndërsa është parashikuar vetëm kontrata me të cilën bashkëshortët rregullojnë disponimin dhe administrimin e pasurisë së përbashkët dhe të veçantë të tyre.

⁹³ Neni 771, 772 i Kodit Civil të Mbretërisë Serbe (1844).

Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur administron dhe disponon me pasurinë e tij të veçantë, nëse bashkëshortët nuk merren vesh ndryshe me kontratë në formë të shkruar.⁹⁴

4.1.8 Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore

Kur flasim për parimin e autonomisë së vullnetit, palët, pra bashkëshortët, kanë të drejtë që marrëdhëniet pasurore t'i rregullojnë në mënyrën që më së miri u përshtatet interesave të tyre, duke u shmangur tërësisht ose pjesërisht nga normat ligjore. Në kornizat e të drejtës familjare, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve ka të bëjë me mundësinë për lidhjen e kontratës martesore me qëllim të shmangies së zbatimit të regjimit pasuror ligjor dhe implementimit të parimit të autonomisë së vullnetit të palëve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Çdo herë e më tepër rritet numri i sistemeve ligjore, të cilat përkrah regjimit pasuror ligjor, u japin hapësirë bashkëshortëve që të vendosin vetë për modelin e regjimit pasuror martesor.

Ndërsa, në vendet të cilat ofrojnë alternativa, mënyra të tjera përpos regjimit ligjor, siç është Republika e Shqipërisë, autonomia e bashkëshortëve del në dritë edhe në rastin kur bashkëshortët përzgjedhin regjimin ligjor që më së miri u përshtatet. Por nga ana tjetër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston ndonjë mundësi ligjore që bashkëshortët të përzgjedhin një regjim pasuror të ndryshëm me çka parashikon ligji, në përputhje me interesat dhe specifikat e marrëdhënies së tyre, pra autonomia e bashkëshortëve në përzgjedhjen e regjimit pasuror martesor është shumë e kufizuar. Gjithashtu, bashkëshortëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut u lejohet ndryshimi i regjimit pasuror gjatë martesës me marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë, me këtë rast nga regjimi ligjor i pasurisë së përbashkët, krijohet regjimi i pronësisë së veçantë të tyre.⁹⁵

⁹⁴ Neni 68, paragrafi 3 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejta të Tjera Sendore

⁹⁵ Metaj-Stojanova, Albana, Misho, Erinda. The Notion, Legal Nature, and Functions of the Marriage Contract. The Importance of Introduction of the Marriage Contract in the Legislation of the Republic of North Macedonia. In *Book of Proceedings of the First International Scientific Conference on Social and Legal Sciences "Good Governance and the Rule of Law in the Perspective of EU Integration"*, pp. 657-670. South East European University, Skopje, North Macedonia, 4 / 2020

4.2 Detyrimi për mbajtje midis bashkëshortëve

Një nga detyrimet e bashkëshortëve që buron nga lidhja e martesës është detyrimi reciprok për mbajtje dhe ushqimin. Detyrimi për mbajtje midis bashkëshortëve ekziston si gjatë martesës, ashtu edhe pas pushimit të saj. Gjatë kohëzgjatjes së martesës, bashkëshortët janë të detyruar, brenda mundësive të tyre, të kontribuojnë për mbajtjen dhe ushqimin e tyre, si dhe të anëtarëve të tjerë të familjes. Megjithatë, kur njëri nga bashkëshortët nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje dhe është i paaftë për punë ose është i papunë, jo për fajin e vet, atëherë ai ka të drejtën e mbajtjes nga bashkëshorti i tij, proporcionalisht me mundësitë e bashkëshortit.⁹⁶

Kur detyrimi për mbajtje nuk plotësohet vullnetarisht, bashkëshorti në nevojë mund t'i drejtohet gjykatës për ta detyruar bashkëshortin tjetër të sigurojë mbajtjen dhe ushqimin e tij. Në raste të caktuara, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, gjykata mundet ta refuzojë kërkesën për mbajtje, nëse mbajtjen e kërkon bashkëshorti i cili me keqdashje dhe pa shkaqe të arsyeshme e ka braktisur bashkëshortin tjetër. Në praktikën gjyqësore janë të rralla rastet kur janë ngritur procedura gjyqësore për të kërkuar mbajtjen nga bashkëshorti gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Zakonisht kërkesa për mbajtje e njërit bashkëshort ngrihet në rastet kur martesë është shkurorëzuar ose faktikisht ka pushuar. Në këto raste bashkëshorti që i përmbush kushtet e parashikuara me ligj ka të drejtë të kërkojë mbajtje. Kur martesë shkurorëzohet, bashkëshorti i pasiguruar që nuk ka mjete për jetesë, ka të drejtë të kërkojë që me vendim gjykate t'i përcaktohet një shumë e caktuar për mbajtje dhe ushqimin, në ngarkesë të bashkëshortit tjetër, në përpjesëtim me mundësitë e tij.

Në këtë rast paraqitja e kërkesës për mbajtje është e lidhur me afate prekluzive dhe mund të parashtrohet:

- 1) deri në përfundimin e seancës kryesore në procedurën për shkurorëzimin ose anulimin e martesës ,dhe

⁹⁶ Neni 185, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen.

2) deri në një vit pas përfundimit të martesës.

Afati është prekluziv për shkak se gjykata shumë më thjesht në kontestin martesor mund të vërtetojë nëse ekzistojnë arsye dhe rrethana për të vendosur për mbajtjen e njërit bashkëshort nga ana e bashkëshortit tjetër, rrethana këto që rrjedhin nga marrëdhëniet në martesë. Në këtë sens, gjykata mund ta refuzojë kërkesën për mbajtje nëse mbajtjen e kërkon bashkëshorti që pa asnjë shkak serioz nga ana e bashkëshortit tjetër, ka pasur sjellje të ashpër dhe të pasjellshme në bashkësinë martesore, apo kur kërkesa e tij do të përbënte një padrejtësi të dukshme për bashkëshortin tjetër. Gjithashtu, gjykata mund ta refuzojë kërkesën për mbajtje, nëse bashkëshortët, për një periudhë të gjatë kohore kanë jetuar të ndarë, dhe në mënyrë të pavarur e kanë siguruar jetesën, apo kur nga rrethanat e rastit vërtetohet se bashkëshorti që kërkon mbajtje nuk është në gjendje më të vështirë materiale se ajo në të cilën ka qenë në momentin e lidhjes së martesës.⁹⁷

Në rastin e anulimit të martesës, të drejtë për të kërkuar mbajtje ka vetëm bashkëshorti i cili ka qenë i ndërgjegjshëm, pra që nuk i ka ditur arsyet për pavlefshmërinë e martesës. Ai mund ta realizojë të drejtën e mbajtjes në të njëjtat kushte që vlejnë për bashkëshortin e shkurorëzuar.

Mbajtja e bashkëshortit mund të vendoset nga gjykata vetëm me kërkesë të tij, që do të thotë se lidhur me këtë çështje gjykata nuk vepron sipas detyrës zyrtare. Për nga natyra, e drejta e mbajtjes e bashkëshortit është me karakter të përkohshëm sepse krijohet për një kohë të caktuar. Ajo trajtohet si ndihmë e përkohshme mbas pushimit të martesës me qëllim që bashkëshorti të sigurojë mjete për jetesë. Për nga natyra juridike, e drejta e mbajtjes e bashkëshortit është e drejtë personale që nuk mund të bartet e as të trashëgohet. Me vdekjen e bashkëshortit e drejta për mbajtje shuhet dhe nuk kalon tek trashëgimtarët e tij.

⁹⁷ Liljana Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 295-296

4.3 E drejta e trashëgimisë ligjore

Ligji për Trashëgiminë përcakton qartë rrethin e trashëgimtarëve ligjorë.⁹⁸ Një nga të drejtat më të rëndësishme të bashkëshortëve është e drejta e tyre për të trashëguar njëri-tjetrin, dhe atë, si trashëgimtarë të rendit të parë. Sipas nenit 13 të Ligjit për trashëgiminë të RMV-së, trashëgiminë e të vdekurit, përpara të gjithëve, e trashëgojnë fëmijët e tij dhe bashkëshorti pasjetues. Ata trashëgojnë në pjesë të barabarta. Ndërsa, në rastin kur bashkëshorti i vdekur nuk ka pasur fëmijë, atëherë pasurinë e tij e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti pasjetues, si trashëgimtarë të rendit të dytë. Në këtë rast, të dy prindërit sëbashku do të trashëgojnë gjysmën e trashëgimisë, ndërsa bashkëshorti pasjetues gjysmën tjetër.⁹⁹

Masivisht, gratë shqiptare heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë, por edhe nga pjesa që u takon nga pasuria e përbashkët pas shkurorëzimit. Megjithatë, mungojnë të dhëna konkrete për gjendjen vetëm të shoqërisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Nëse flasim historikisht duhet të kemi parasysh se: shikuar historikisht, fakti i lidhjes së martesës ka pasur një ndikim shumë më të dobët në formimin e rradhëve ligjore të trashëgimit se sa gjinia.¹⁰⁰ Në të drejtën zakonore shqiptare gruaja nuk trashëgonte as tek prindërit e as tek burri. Në të drejtën e sheriatit gruaja mund të paraqitet si trashëgimtare ligjore, megjithatë në masë të reduktuar në krahasim me burrin me arsyetimin se është burri ai që është i detyruar të mbajë familjen. Pjesa trashëgimore e vajzave të martuara në pasurinë e babait të tyre, quhej miraz.¹⁰¹ Për herë të parë Kodi Civil Shqiptar i vitit 1929, rregulloi kontratën martesore si mjet për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe i njohu gruas të drejtën e trashëgimisë.¹⁰²

Kjo gjë ka të bëjë me pjesën diskriminuese të cilën e ka pasur si dhe e ka gruaja në shoqëri por edhe në familje. Një kohë shumë të gjatë gratë janë konsideruar si të huaja si dhe pa të drejta trashëgimore.

⁹⁸ Neni 12 i Ligjit për Trashëgiminë i RMV-së

⁹⁹ Neni 16 i Ligjit për Trashëgiminë i RMV-së

¹⁰⁰ Blagojevic, dr Borislav, Nasledno parvo, Naucna knjiga, Beograd, 1961, fq.39

¹⁰¹ Neni 1655 i Kanunit të Lumës.

¹⁰² (Omari, 2007: 19)

Duhet thënë që gruaja sot e kësaj dite ende nuk e merr pjesën e trashëgimisë që i takon nga prindërit për shkak të heqjes dorë nga trashëgimia.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë punim u synua të trajtohen dhe analizohen në mënyrë më të detajuar pasojat juridike të lidhjes së martesës për bashkëshortët. Martesa dihet se paraqet një institucion shoqëror dhe juridik për shkak se është një ndër format e organizimit shoqëror e cila rregullohet me norma juridike. Normat juridike me anë të së cilës rregullohet martesa janë të karakterit të detyrueshëm dhe palët nuk mund t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre, prandaj ajo përbën një institucion juridik të mbrojtur nga shteti.

Rregullimi i këtyre marrëdhënieve familjare-martesore sipas Ligjit për Familje në Maqedoninë e Veriut, bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë sipas të cilit gruas ,si dhe burrit u garantohen të drejta plotësisht të barabarta. Për të qenë një martesë e vlefshme ajo duhet të lidhet në formën e paraparë ligjore. Ligji parasheh të ashtuquajturën formë solemne për lidhjen e martesës. Me ligj nuk është përcaktuar kompetenca tokësore e organit për lidhjen e martesës, ashtu që bashkëshortët kanë të drejtë të pakufizuar të zgjedhjes së vendit ku do të lidhin martesën. Akti kulminant, ai solemn i lidhjes së martesës mbahet në hapësirë të përcaktuar për këtë, por sipas kërkesës së bashkëshortëve e për shkaqe të arsyeshme mund të mbahet edhe në ndonjë vend tjetër.

Martesa dhe lidhja e saj është mëse e “shenjtë” për të gjithë, jo vetëm në ditët e sotme, por që nga koha e antikës, mesjetës, kapitalizmit, renesancës para dhe pas luftërave botërore dhe deri në ditët e sotme. Ajo është një nga fushat të cilat duhen reformuar për të dëshmuar se jemi pjesë e shoqërive të civilizuara.

Kur jemi krejt në përfundim, parashtrohen disa rekomandime të cilat janë në funksion të zgjidhjes së problemeve që paraqet legjislacioni dhe praktika, në kuadrin e regjimit pasuror martesor dhe jo vetëm. Prandaj mund të themi se, për dallim nga shumë vende të rajonit, ku është kryer një reformë për t'u lavdëruar në anën e rregullimit ligjor të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve ,si dhe shumë anëve të tjera të lidhjes martesore, që i përgjigjet më së miri ndryshimeve sociale dhe ekonomike të viteve të fundit, ligjvënësi në Maqedoninë e Veriut ka ende shumë punë për të bërë sa i përket kësaj pjese.

Kur flasim për problematikën lidhur me nevojën për harmonizim të legjislacionit të Maqedonisë së Veriut dhe atë të vendeve evropiane i shtohet dhe mosnjohja ose thënë ndryshe moszbatimi i dispozitave ligjore ekzistuese që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa për ruajtjen e balancës ndërmjet unitetit të familjes dhe pavarësisë pasurore të bashkëshortëve, ligjvënësi ka parashikuar si regjim ligjor atë të pasurisë së përbashkët, që shpreh solidaritetin midis bashkëshortëve. Megjithatë, e drejta për të shmangur zbatimin e regjimit ligjor është e kufizuar dhe manifestohet vetëm nëpërmjet ndarjes së pasurisë së përbashkët gjatë martesës dhe vendosjes së regjimit të kontraktuar të pasurive të ndara. Kur flasim për parimet, një nga parimet mbi të cilin ligjvënësi ka bazuar rregullimin e regjimit pasuror martesor, përveç parimit të barazisë së bashkëshortëve, solidaritetit në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga plotësimi i nevojave të familjes, parimit të autonomisë së vullnetit edhe pse jo i shprehur në formën e tij më të plotë, është dhe parimi i ndryshueshmërisë së regjimit pasuror, gjatë kohëzgjatjes së martesës.

Kur jemi te regjimi i pasurisë së përbashkët mund të themi se ai është më i përshtatshëm për bashkëshortët e rinj në moshë, të cilët nuk kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre, para lidhjes së martesës. Nga ky regjim mund të themi se është i përshtatshëm dhe për shoqëritë tradicionale, në të cilat shpesh njëri bashkëshort është ekonomikisht i varur nga bashkëshorti tjetër, kjo bazuar në gjendjen aktuale ekonomike të vendit dhe rasteve që hasim në përditshmëri. Por, nga ana tjetër, regjimi i pasurive të ndara u përshtatet më tepër bashkëshortëve, të cilët kanë pasuri të konsiderueshme në pronësi të tyre, para lidhjes së martesës, ose kanë një disbalancë të theksuar të pasurisë, ose kanë fëmijë nga martesa të mëparshme, apo ushtrojnë veprimtari tregtare me rrezik të lartë financiar, rrezik ndaj të cilit nuk duan ta ekspozojnë dhe pasurinë e familjes apo të bashkëshortit tjetër. Ligjvënësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ka promovuar sistemin e ndarjes së pronësisë së përbashkët në pjesë të barabarta, por pa i qëndruar konsekuent deri në fund, pasi në praktikë, sistemi i pjesëve të barabarta kombinohet me sistemin e ndarjes së pronësisë së përbashkët sipas kontributit.

Kur jemi te situata socialo-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

modeli i ekonomisë së lirë të tregut janë reflektuar ndjeshëm dhe në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve dhe sigurisht që kërkojnë afirmim të pozitës juridiko-pasurore të bashkëshortëve, në sensin e ofrimit të një autonomie më të gjerë, përse i përket rregullimit të marrëdhënieve pasurore të tyre. Mund të konsiderojmë se ka mjaft arsye që de lege ferenda, të krijojë më shumë zgjidhje të mundshme për bashkëshortët, në mënyrë që ata të mund të vendosin sipas vullnetit të lirë për njërin prej tyre.

Në rast se regjimi i pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, vazhdon të ngelet regjim i vetëm ligjor, pothuajse ekskluziv, theksoj që ai duhet të rregullohet në mënyrë më të detajuar, me dispozita ligjore më koherente, që nuk krijojnë problematika në zbatimin e tyre. Në kuadër të regjimeve pasurore martesore në Maqedoninë e Veriut, rekomandohet të kryhen studime ligjore, konferenca dhe trajnime të gjyqtarëve, noterëve dhe avokatëve me qëllim kuptimin dhe interpretimin më të mirë të dispozitave.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Abdulla Aliu, E drejta civile, Prishtinë, 2013
- Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, 2007.
- Albana Metaj-Stojanova "Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile" në "Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja", Tetovë, 2022
- Albana Metaj-Stojanova, A Comparative View on the Legal Protection of Family Home and the Current Situation in RM. In *Proceedings of the 11th Annual South-East European Doctoral Student Conference: Infusing Research and Knowledge in South-East Europe*, pp. 109-119. South-East European Research Centre, Thessaloniki, Greece, 5 / 2017, marrë nga: <https://www.seerc.org/yrrw/2017/files/DSC2017-Proceedings.pdf>
- Albana Metaj-Stojanova, Administration and Disposal of the Joint Property of Spouses in the Republic of Macedonia. In *Proceedings of the XVth Jubilee International Scientific Conference "Knowledge in Practice", Bansko, Bulgaria*, pp. 683-690. Institute of Knowledge Management, Skopje, Macedonia, 12 / 2017.
- Albana Metaj-Stojanova, Misho, Erinda. The Notion, Legal Nature, and Functions of the Marriage Contract. The Importance of Introduction of the Marriage Contract in the Legislation of the Republic of North Macedonia. In *Book of Proceedings of the First International Scientific Conference on Social and Legal Sciences "Good Governance and the Rule of Law in the Perspective of EU Integration"*, pp. 657-670. South East European University, Skopje, North Macedonia, 4 / 2020
- Albana Metaj-Stojanova, Regjimet pasurore jo me kontratë. Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me fokus krahasues me legjislacionin shqiptar. Tiranë, 2019, marrë nga: <https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2019/07/Albana-Metaj-Stojanova.pdf>

- Alexander, G.S. “The New Marriage Contract and the Limits of Private Ordering”. Indiana Law Journal. Vol 73 (1998).
- Blagojevic, dr Borislav, Nasledno parvo, Naucna knjiga, Beograd, 1961.
- Boiche A, (2007) “Marriage Contract and prenuptial agreement in French Law”, Paris.
- Bruce W. Frier and Thomas A.J. McGinn, A Casebook on Roman Family Law (Oxford University Press, 2004).
- Dhima, Ken, E drejta romake, Tiranë, 2011.
- Dr Nerimana Traljic Dr Suzana Bubic: “Porodicno parvo”, Studentska stamparija Universiteta Sarajevo.
- Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, E drejta familjare, Tetovë, 2020.
- Fatmire Lumani, E drejta e punës, Tetovë, 2011.
- Francesca C, (2011), Gli accordi prematrimoniali, Giuffrè, Milano, 2011.
- Frederique Granet: Le droit de la famille, presses Universitaires de Grenoble, 1997.
- Gëzime Starova, E drejta e punës, Logos A, Shkup, 2004.
- Hamdi Podvorica “E drejta familjare”, Universiteti Iliria / Rominor, Prishtine, 2006. Dr. Mira Alincic Ana Bakaric – Mihanoviq : Porodicno Pravo, (Zakonodavstvo SR Hrvatska) Zagreb, 1980.
- Ineta Ziemele dhe Gunnar G.Schram: Deklarata universal mbi të drejtat e njeriut, INDNJ, Oslo, Norvexhi.
- Kanuni i Dibrës, 2007.
- Kanuni i Labërisë, 2006.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999.
- Kanunit të Lumës.
- Kapitulli 2 i Kodit civil Francez (1804).
- Kodi Civil i vitit, 1929.
- Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut.
- Kodit Civil Gjerman.
- Kodit Civil të Mbretërisë Serbe (1844).

- Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut.
- Ligji për Familjen i Serbisë, Neni 171, “Sluzbeni Glasnik RS” br.18/2005; Ligji për Familjen i Kroacisë, Neni 36, “Narodne Novine RH”, br.103/2015; Ligji për Familjen i Kosovës, Neni 47, “Gazeta Zyrtare” nr.4/2006.
- Ligji për Procedurë Jashtëkontestimore i RMV-së.
- Ligji për Trashëgiminë i RMV-së.
- Ligjit për Marrëdhëniet Pasurore të Bashkëshortëve të RPM.
- Marina Janjic -Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic:” Porodicno parvo”, Izdavocko preduzeHHce “Homoc” d.o.o. Beograd, 1999.
- Nicolas F, Marion L, “Wealth, marriage and prenuptial agreements in France (1855 - 2010)” 2018, vol. 68, çështja C.
- Nuni A, (2012) “Parime të përgjithshme të së drejtës Civile”, Tiranë.
- Scheidel, Walter (2006) "Population and Demography," Princeton/Stanford Working Papers in Classics.
- Spirovikj Trpenovska, Dejan Mickovikj, Angel Ristov, Semejno pravo, Kulturna Ustavnova “Blesok”, Skopje, 2013.
- Zaçe, V. (1996). Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Shtëpia Botuese Logoreci, Tiranë.
- ЗАКОН ЗА СЕМЕЈСТВОТО (LIGJI PËR FAMILJE)
https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osemejstvo_osnoven.pdf
- Љиљана Спировиќ – Трпеновска Семејно право НИП „Студентски збор“ – Скопје 2004 година.
- Семејно право во СФРЈ, Скопје, 1977, 1980 – Миле Хаџи Василев.
- Семејството во Европа XVI-XXI век, Дејан Мицковиќ, Културна установа Блесок, Скопје, 2008.